

AFTËSITË DIGJITALE PËR TË MOSHUARIT

Praktikat më të mira nga Shqipëria,
Franca, Italia dhe Spanja



SHËNIM

Ky botim është prodhuar me mbështetjen financiare të BE. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e autorit/autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e BE ose të Agjencisë Ekzekutive të Edukimit dhe Kulturës të Bashkimit Evropian (EACEA).

© Organizatat partnere të projektit DIGI-LEARN



Agis, Note et Innove
International

femxa





Tabela e përmbajtjes

Rreth projektit DIGI-LEARN	5
Rreth raportit	6
Hulumtimi i Burimeve Sekondare	9
<ul style="list-style-type: none">• Ndryshimet demografike në Europë• Strategjia digjitale e BE• Politika digjitale për njerëzit dhe shoqërinë: Aftësitë digjitale dhe shërbimet publike• Panorama e përgjithshme digjitale në Shqipëri, Francë, Itali dhe Spanjë	
Gjetjet kryesore	18
<ul style="list-style-type: none">• Barrierat për përfshirjen e të moshuarve në botën digjitale• Kërkesat kryesore për trajnimin e stafit që merren me ofrimin e kurseve të TIK për të moshuarit• Teknologjitë efektive për t'u mësuar të moshuarve aftësitë digjitale• Teknologjitë efektive për aftësimin digjital të të moshuarve• Rekomandime	
Praktikat e mira	31
<ul style="list-style-type: none">• Praktikat e mira në Shqipëri• Praktikat e mira në Spanjë• Praktikat e mira në Francë• Praktikat e mira në Itali	

GRAFIKËT DHE FIGURAT

Figura 1: Ndryshimet demograike në Europë (2003 - 2023).....	10
Figura 2: Grupmosha 65-79 vjeç (si % totale e popullsisë).....	11
Figura 3: Aftësitë digjitale dhe shërbimet publike.....	13
Figura 4: Treguesit kryesorë të performancës në Itali - Aftësitë digjitale bazë.....	14
Figura 5: Treguesit kryesorë të performancës në Spanjë - Aftësitë digjitale bazë.....	15
Figura 6: Treguesit kryesorë të performancës në Francë - Aftësitë digjitale bazë.....	16
Figura 7: Treguesit kryesorë të performancës në Shqipëri - Aftësitë digjitale bazë.....	17
Figura 8: Barrierat për përfshirjen e të moshuarve në epokën digjitale.....	19
Figura 9: Kërkesat kryesore të trajnimit për edukatorët.....	23
Figura 10: Teknologjitë ose mjetet që janë veçanërisht efektive për mësimin e aftësive dixhitale për të moshuarit.....	25

RRETH PROJEKTIT DIGI-LEARN



Epoka digjitale po transformon mënyrën si jetojmë, ndërveprojmë, mësojmë dhe punojmë. Teksa ofrohen mundësi të jashtëzakonshme në procesin e të nxënit, duhet vënë në dukje, po ashtu, nevoja për zhvillimtë vazhdueshëm të aftësive digjitale tek të gjithë grupmoshat.

Bazuar në këtë qasje, projekti DIGI-LEARN ka si qëllim të pajisë qytetarët me aftësitë e nevojshme për t'u përshtatur me ndryshimet e diktura nga teknologjia në tregun e punës

Objektivat kryesore të projektit DIGI-LEARN parashikojnë:

- **Identifikimin e praktikave më të mira** në aksesin digjital bazuar në “të mësuarit për të nxënë”;
- **Zhvillimin e materialeve të trajnimit digjital** të hartuara për të moshuarit dhe personat me njohuri dhe aftësi të ulëta digjitale, për të rritur aftësitë e tyre në epokën digjitale;
- **Krijimin e një kornize metodologjike për trajnerët** që punojnë me grupet vulnerable, të cilët përballen me përjashtim social, papunësi afatgjate ose të rikthyer nga emigrimi.



RRETH RAPOTIT



Vendet e Bashkimit Evropian, dhe jo vetëm, po përballën me ndryshime të mëdha si plakja e popullsisë dhe inovacioni digjital. Inovacioni digjital mund të jetë një mundësi për të përmirësuar cilësinë e jetës së njerëzve, në shoqëritë që po përballen me plakjen, nëpërmjet kalimit në sisteme shëndetësore dhe përkujdesi më të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, duke sjellë rritje ekonomike dhe më shumë vende pune.

Ky raport fokusohet në hulumtimin dhe vlerësimin e procesit të digjitalizimit dhe zbatimit të metodës së të mësuarit gjatë gjithë jetës në këtë fushë, duke evidentuar, mbledhur, analizuar dhe ndarë praktikatat më të mira për aftësitë digjitale tek të moshuarit në vendet partnere të projektit: Shqipëri, Itali, Spanjë dhe Francë. Qëllimi është që, bazuar në praktikatat më të mira në zbatimin e strategjive të të mësuarit për të nxënë në fushën digjitale, të krijohen programe trajnimi të fokusuara në rritjen e njohurive dhe kapaciteteve në përdorimin e mjeteve digjitale të të moshuarve me aftësi të ulëta digjitale

Metodologjia

Analiza e paraqitur në këtë dokument është bazuar në një metodologji që kombinon rishikimin e literaturës dhe intervistat e thelluara në katër vendet partnere: Shqipëri, Itali, Francë dhe Spanjë

Rishikim i literaturës

Hulumtimi shqyrton gjendjen aktuale të nivelit të njohurive dhe aftësive digjitale të moshës së tretë, si dhe programet specifike ekzistuese të trajnimit të disponueshme për ta, në secilin prej vendeve të përfshira në projekt. Hulumtimi ka qasje krahasuese të situatës në Shqipëri, Itali, Spanjë dhe Francë.

Secili prej vendeve i përfshirë në këtë hulumtim ka kryer një rishikim të thelluar të literaturës, duke u fokusuar në disa fusha kyçe:

- Tendencat demografike të popullsisë: Përdorimi i internetit, hendeku digjital bazuar në gjini dhe moshë.
- Analiza e politikave dhe programeve: Identifikimi dhe analizimi i nismave kombëtare dhe rajonale që kanë si qëllim përmirësimin e nivelit të njohurive dhe aftësive digjitale të të moshuarit, duke përfshirë planet strategjike dhe programet specifike.
- Iniciativat shoqërore dhe advokimi: Perceptimi mbi iniciativat shoqërore dhe fushatat që mbështesin përfshirjen digjitale të të moshuarve, duke theksuar ndikimin dhe përgjigjen e institucioneve publike.



Metoda Sasiore

Në këtë hulumtim është përdorur një metodologji mikse, që përfshin të dhënat cilësore, nëpërmjet identifikimit dhe analizimit të burimeve sekondare, dhe të dhënat sasiore. Qasja sasiore është mbështetur në kombinimin e një ankete të zhvilluar me palët e interesuara. Po ashtu, çdo partner kreu intervista të thelluara me ekspertë dhe palë të interesuara për të vlerësuar nevojat e institucioneve që ofrojnë formim profesional për të gjitha moshat, përfshi edhe të moshuarit, në të gjitha fushat, përfshi edhe ICT, bazuar në parimin e të mësuarit gjatë gjithë jetës. Pyetjet u përqendruan në nivelin aktual të shërbimeve për të moshuarit, fushat që kërkojnë përmirësim, strategjitë për të rritur ndikimin institucional dhe nevojat për trajnim për stafin trajnues.

Tipologjia e palëve të interesuara që u përfshinë në intervistat e thelluara:

- Biblioteka publike që kontribuojnë në aksesin në informacion elektronik dhe trajnimin në alfabetizim digjital për të moshuarit;
- Organizata të të moshuarve që ofrojnë programe arsimore dhe shërbime në ICT për të moshuarit;
- Institucione akademike që ofrojnë trajnime për të rritur dhe qytetarët e moshuar;
- Shtëpitë e të moshuarve që ofrojnë programe arsimore për të moshuarit në ambientet e tyre;
- Organizata që promovojnë përdorimin efektiv të teknologjisë në jetën e përditshme, si qendra të asistencës rurale, si dhe shoqata të personave me aftësi të kufizuara.

Shembuj pyetjesh

1. Sipas jush, cilat shërbime kryesore ofrohen aktualisht për të moshuarit në lidhje me edukimin në teknologjitë e informacionit dhe komunikimit? Si e vlerësoni efektivitetin e këtyre shërbimeve?
2. Cilat janë sfidat kryesore me të cilat përballen të moshuarit në zhvillimin e kompetencave digjitale ose në arsimin për teknologjitë e informacionit dhe komunikimit?
3. Në mendimin tuaj, cilat janë nevojat kryesore për trajnimin e stafit që punon me të moshuarit në fushën e arsimit për teknologjitë e informacionit dhe komunikimit?
4. A ekzistojnë teknologji ose mjete specifike që, sipas mendimit tuaj, janë veçanërisht efektive për mësimin e aftësive digjitale për të moshuarit?
5. Si mund të përmirësojnë institucionet ndikimin e tyre në promovimin e kompetencave digjitale tek moshat e treta?
6. A mund të ndani shembuj të iniciativave ose programeve të suksesshme që kanë synuar përmirësimin e kompetencave dhe alfabetizimit digjital të të moshuarit?



Intervista me të rritur dhe mosha të treta

- Grupmosha mbi 45 vjeç me aftësi të ulëta digjitale.
- Grupmosha mbi 45 vjeç që kanë aftësi digjitale mesatare dhe janë regjistruar në kurse dhe trajnime për të fituar aftësi digjitale gjatë 12 muajve të fundit.

Shembuj Pyetjesh:

1. *Cilat janë, sipas jush, shërbimet kryesore që ofrohen aktualisht për të moshuarit në lidhje me arsimin në teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (ICT), dhe sa efektive i konsideroni ato?*
2. *Cilat janë sfidat kryesore që të moshuarit përjetojnë në përvetësimin e aftësive digjitale apo në përfshirjen në arsimin ICT?*
3. *Sipas mendimit tuaj, cilat janë kërkesat më të rëndësishme për trajnimet e stafit që punon me arsimin ICT për të moshuarit?*
4. *A ekzistojnë teknologji ose mjete specifike që mendoni se janë veçanërisht efektive për mësimin e aftësive digjitale për të moshuarit? Nëse po, cilat janë ato?*
5. *Si mund të përmirësojnë institucionet ndikimin e tyre në rritjen dhe promovimin e aftësive digjitale te qytetarët e moshuar?*
6. *A mund të ndani shembuj të iniciativave ose programeve të suksesshme që kanë pasur për qëllim përmirësimin e aftësive dhe alfabetizmit digjital te të moshuarit?*
7. *A mendoni se mësimi me ndihmën e pajisjeve digjitale është i domosdoshëm në ditët e sotme? Pse?*
8. *A mendoni se përdorimi i pajisjeve digjitale për qëllime arsimore na bën më pak reflektues dhe më të varur? Pse?*

Metoda Cilësore:

Kerkimi përfshiu gjithashtu mbledhjen e praktikave të mira në aftësitë digjitale dhe të moshuarit si mësues digjitalë në nivel kombëtar.

Qëllimi ishte të shqyrtoheshin qasjet e suksesshme, nismat për përmirësimin e aftësive dhe projektet me ndikim të provuar në mbylljen e hendekut të aftësive digjitale, që kanë potencialin të riprodhohen në shtete dhe kontekste të ndryshme.

Çdo partner ka identifikuar 3-5 praktika të mira në nivel kombëtar.



RISHIKIM I LITERATURËS

Pikëpamja e përgjithshme digjitale në katër vendet partnere: Shqipëri, Francë, Itali, Spanjë.


NDRYSHIMET DEMOGRAFIKE NË EUROPË



Më 1 janar 2023, popullsia në Bashkimin Europian (BE) arriti në 448.8 milionë njerëz. Vendi me popullsinë më të lartë në BE ishte Gjermania (84.4 milionë, 19% e totalit të BE-së), e ndjekur nga Franca (68.2 milionë, 15%), Italia (59.0 milionë, 13%), Spanja (48.1 milionë, 11%) dhe Polonia (36.8 milionë, 8%). Së bashku, këto pesë shtete të BE-së përbënin 66% të popullsisë së BE-së¹

Mosha mesatare e popullsisë u rrit gjatë periudhës 2003-2023, nga 39.0 vjeç në vitin 2003, në 42.2 vjeç në vitin 2013 dhe në 44.5 vjeç në vitin 2023 (më 1 janar). Kjo do të thotë që mosha mesatare e popullsisë në BE u rrit me 5.5 vite gjatë kësaj periudhe 20-vjeçare. Ndër shtetet anëtare të BE-së, Italia rezulton me moshën më të lartë mesatare të popullsisë, që shkon në 48.4 vjeç.

Figura 1: Ndryshimet demografike në Europë (2003 - 2023)



[1] <https://ec.europa.eu/eurostat/web/interactive-publications/demography-2024>




Një popullsi në plakje

Popullsia e BE-së po plaket, gjë që është e dukshme nga statistika të ndryshme që përfshijnë përqindjen e popullsisë së moshuar, raportin e varfërisë për moshën e tretë dhe moshën mesatare të popullsisë. Nga viti 2003 deri në 2023, përqindja e personave 80 vjeç e lart u rrit nga 3.7% në 6.0%, ku Greqia dhe Letonia shënuan rritjet më të mëdha. Ndërkohë, përqindja e individëve mbi 65vjeç u rrit me 5.1 pikë përqindje, nga 16.2% në 21.3%. Në të njëjtën kohë, përqindja e fëmijëve nën 15 vjeç ra nga 16.4% në 14.9%, me rëniet më të mëdha në Maltë dhe Qipro.

Ky ndryshim demografik paraqet sfida, veçanërisht në digjitalizim dhe integrimin e të moshuarve në botën dixhitale. Sipas Indeksit të Ekonomisë dhe Shoqërisë Dixhitale 2022,² vetëm 54% e evropianëve të moshës 16-74 vjeç zotërojnë aftësi bazë dixhitale, ndërsa përqindjet janë edhe më të ulëta tek të moshuarit.³ Pritet që digjitalizimi të thellojë më tej mungesën e aftësive tek punonjësit në moshë të madhe, pasi hendeku i moshës në përdorimin e teknologjive digjitale rritet me kompleksitetin e tyre.

Figura 2: Grupmosha 65-79 vjeç (si % e totalit të popullsisë)



[2] <https://ec.europa.eu/eurostat/web/interactive-publications/demography-2024>

[3] https://read.oecd-ilibrary.org/employment/preventing-ageing-unequally_9789264279087-en#page57

STRATEGJIA DIGJITALE E EU



Në një kohë kur interneti dhe teknologjitë digjitale po transformojnë botën tonë, një Evropë e përshtatshme për epokën digjitale është një nga gjashtë prioritetet politike të Komisionit Evropian. Në mars 2021, Komisioni propozoi zhvillimin drejt Dekadës Digjitale⁴. Programi i politikave të Dekadës Digjitale synon të përmirësojë digjitalizimin e Evropës deri në vitin 2030 "me në qendër njeriun", nëpërmjet vendosjes së "objektiva të matshëm" për lidhjen me internet, përdorimin e teknologjisë dhe rritjen e aftësive digjitale të forcës së punës.

Compass përshkruan katër pika kyçe për këtë rrugëtim: aftësitë digjitale, infrastrukturën digjitale të sigurt dhe performuese, transformimin digjital të bizneseve dhe digjitalizimin e shërbimeve publike. Ky program politik është në përputhje me normat dhe standardet e BE-së për të forcuar sovranitetin digjital të BE-së. Një sërë instrumentesh buxhetore do të mbështesin investimet e nevojshme për të ndërtuar Dekadën Digjitale të Evropës mbi baza të forta.

Agjenda kërkon një intensifikim të punës, që ka filluar në dekadën e kaluar, për të përshpejtuar transformimin digjital të Evropës, duke u bazuar në përparimin drejt një Tregu Digjital të Pashfrytëzuar plotësisht.

Strategjia e Tregut Digjital të BE-së hapi rrugën për një harmonizim më të ngushtë digjital midis Shteteve Anëtare të BE-së. E nisur në vitin 2015, ajo synonte të kontribuonte në zhvillimin ekonomik, rritjen e punësimin, konkurrencës, investimeve dhe inovacionit në BE, duke u bazuar në tri shtylla:

- **Aksesi:** përmirësimi i aksesit për konsumatorët dhe bizneset në mallrat dhe shërbimet digjitale në mbarë Evropën;
- **Mjedisi:** krijimi i kushteve të duhura dhe një mjedisi të barabartë për lulëzimin e rrjeteve digjitale dhe shërbimet inovative;
- **Ekonomia dhe Shoqëria:** maksimalizimi i potencialit të rritjes së ekonomisë digjitale.

Duke qenë prioritet i BE-së, digjitalizimi është edhe një prioritet për vendet partnere strategjike të BE-së për ndërtimin e një mjedisi digjital më të mirë dhe më të harmonizuar. Objektivat e politikës së Partneritetit Lindor (EaP) pas vitit 2020 përfshijnë veprime që synojnë mbështetjen e zhvillimit të Tregut Digjital të Pashfrytëzuar si: investime në ekonomi konkurruese dhe inovative, në shoqëri, njerëz dhe dije, në siguri dhe qëndrueshmëri ndaj kibernetikës dhe në transformimin digjital.

Zgjerimi i përfitimeve të Tregut Digjital të Pashfrytëzuar në vendet partnere të Lindjes është një objektiv i rëndësishëm i Bashkimit Evropian.

[4] <https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/policies/europes-digital-decade>




Politika digjitale për njerëzit dhe shoqërinë: Aftësitë digjitale dhe shërbimet publike

Pavarësisht se numri i të moshuarve që janë të lidhur me internet është në rritje, ende ka miliona njerëz mbi 55 vjeç që nuk kanë informacione mbi internetin. Dhe, ndërsa faktorë të tillë si të ardhurat dhe nivelet e arsimit luajnë rol të rëndësishëm, moshë mbetet arsyeja kryesore e përjashtimit nga aksesit digjital.

Iniciativa e Dekadës Digjitale në Evropë u krijua me vizionin që teknologjia digjitale të përfitohet nga të gjithë qytetarët në Bashkimin Evropian (BE). E propozuar në vitin 2021, ajo vendosi një seri objektivash për dekadën e ardhshme, deri në vitin 2030, të hartuara për të fuqizuar qytetarët dhe për të ndihmuar zhvillimin e bizneseve. Megjithatë, një raport i fundit sugjeron se progresi aktual mund të jetë i pamjaftueshëm për të arritur këto objektiva.

Raporti "Gjendja e Dekadës Digjitale" identifikon boshllëqe të rëndësishme, përfshirë nevojën për më shumë investime, si në nivelin e BE-së ashtu edhe në nivelin e vendeve anëtare. Objektivat për aftësitë digjitale janë "ende shumë larg arritjes", me vetëm 55.6% të popullsisë së BE-së që ka të paktën aftësi digjitale bazë. Rrjetet e fibrave të nevojshme që përdoruesit të shfrytëzojnë teknologjitë më të avancuara, duke përfshirë AI-në dhe i-cloud, arrijnë vetëm 64% të familjeve, ndërsa 5G me cilësi të lartë arrin vetëm 50% të territorit të BE-së. Një sfidë tjetër e madhe e identifikuar është përballja me përhapjen e kufizuar të teknologjive digjitale jashtë qyteteve të mëdha.

Figura 3: Aftësitë digjitale dhe shërbimet publike



* Not a KPI but gives an important indication on high quality 5G coverage
* The former Big data indicator is now replaced by the take up of Data analytics technologies. Progress are not fully comparable.

The EU says it has a way to go to meet key digital transformation targets.

Image: European Commission

[5] <https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/policies/europes-digital-decade>




Për herë të parë, shtetet anëtare i paraqitën Komisionit hartat e tyre kombëtare, duke detajuar veprimet e planifikuara për të arritur objektivat e Dekadës Digjitale 2030. Komisioni publikoi rekomandime të veçanta për çdo shtet anëtar të BE-së dhe rekomandime të përgjithshme për të adresuar mangësitë e identifikuara.

*Panorama e përgjithshme digjitale në Itali*⁶

Italia është një nga shtetet anëtare të BE-së me nivelet më të ulëta të aftësive digjitale bazë. Në vitin 2023, vetëm 45.8% e popullsisë në Itali kishin të paktën aftësi digjitale bazë, krahasuar me mesataren e BE-së prej 55.6%. Gjatë dy viteve të fundit nuk ka pasur përmirësime të rëndësishme në nivelin e përgjithshëm (me një rritje vetëm 0.2% në vit në krahasim me vitin 2021). Ky tregues është veçanërisht i ulët tek personat me arsim të ulët ose pa arsim formal, me vetëm 22.6% të tyre me të paktën aftësi digjitale bazë (kundrejt 33.6% në BE), dhe për grupmoshën 55-74 vjeç që aftësitë bazë digjitale arrijnë në 30% (kundrejt 37% në BE).

Popullsia që jeton në zona rurale gjithashtu tregon nivele më të ulëta të aftësive digjitale, me 40.6% e atyre që kanë të paktën një nivel bazë (kundrejt 47.5% në BE). Hendeku midis Italisë dhe pjesës tjetër të BE-së është i dukshëm, veçanërisht kur merret parasysh gjenerata më e re dhe njerëzit që jetojnë në zona urbane, grupe që zakonisht pritet të kenë nivele më të larta aftësish digjitale. Në Itali, vetëm 59% e njerëzve të moshës 16-24 vjeç dhe 54% e atyre të moshës 25-54 vjeç kanë të paktën aftësi digjitale bazë. Mesataret e BE-së janë 10 pikë përqindjeje më lart, me përkatësisht 70% dhe 64%. Po ashtu, vetëm 51% e popullsisë që jeton në zona urbane ka të paktën aftësi digjitale bazë, kundrejt 63% në BE, me një hendek prej 12 pikësh përqindjeje. Italia i afrohet situatës së përgjithshme të BE-në vetëm kur bëhet fjalë për aftësitë digjitale të personave me nivele të mesme dhe të larta arsimimi.

Figura 4: Treguesit kryesorë të performancës në Itali - Aftësitë digjitale bazë



[6] <https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/policies/europes-digital-decade>




Panorama e përgjithshme digjitale në Spanjë

Spanja sjell një kontribut me vlerë për objektivin e Dekadës Digjitale të BE-së për aftësitë digjitale bazë duke shfaqur një dinamikë pozitive. Në vitin 2023, **66.2%** e popullsisë së Spanjës kishte të paktën aftësi digjitale bazë, përqindje që rezulton më e lartë se mesatarja e BE-së, që është 55.6%. Megjithatë Spanja nuk renditet ndër vendet lider të BE në këtë fushë. Rritja mesatare vjetore është në aftësitë digjitale bazë të popullsisë arrin 1.6%, ndërsa mesatarja e BE-së është 1.5%. Treguesit e tjerë të aftësive digjitale, si përdorimi i internetit (94.5%), aftësitë digjitale mbi nivelin bazë (38.7%) dhe aftësitë digjitale bazë në krijimin e përmbajtjes (73.8%) tregojnë një performancë të ngjashme në këto fusha.

Pavarësisht se niveli i aftësive digjitale në të gjitha grupet socio-demografike në Spanjë tejkalon mesataren e Bashkimit Evropian, ende ekzistojnë diferenca të konsiderueshme midis grupeve. Diferencat lidhen më shumë me moshën, profesionin dhe nivelin e arsimit, dhe jo aq me vendbanimin dhe gjininë (66% e popullsisë me aftësi digjitale bazë përfshijnë në mënyrë të njëjtë të dyja gjinitë).

Figura 5: Treguesit kryesorë të performancës në Spanjë- Aftësitë digjitale bazë⁷



Në përgjithësi, mes popullsisë spanjolle, aktivitetet më të shpeshta që kryhen në internet në vitin 2023 janë të lidhura me komunikimin (93.8%), ndër të cilat spikasin shërbimet e mesazheve të shpejta dhe bisedat me video, të ndjekura nga shërbimet e informacionit (85.8%) dhe blerjet online (69.6%). Megjithatë, grupmosha e popullsisë 65-74 vjeç më së shumti e përdorin internetin për shërbime bankare, kërkimi informacioni për mallra ose shërbime si dhe rezervimin e takimeve në qendrat shëndetësore.

[7] <https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/policies/europes-digital-decade>




Panorama e përgjithshme digjitale në Francë

Franca ka dhënë një kontribut pozitiv për objektivin e Dekadës Digjitale të BE-së për aftësitë digjitale bazë, por me dinamika të kufizuara. Në vitin 2023, 59.7% e popullsisë së Francës zotëronte të paktën aftësi digjitale bazë, që rezultoi më e lartë se mesatarja e BE-së me 55.6%, por duke u renditur pas vendeve liderë në këtë fushë. Ky tregues rezultoi më i ulët se ai i evidentuar në vitin 2021 (62.0%), ndërsa BE-ja ka shënuar një përparim, edhe pse me hapa të vegjël, gjatë të njëjtës periudhë. Kjo rënie mund të shpjegohet me efektet pas COVID-19, ku është vënë re një rënie në aktivitetet digjitale të popullsisë, për shembull, më pak punë nga shtëpia ose përdorim i e-commerce midis viteve 2021 dhe 2023.

Treguesit e tjerë të aftësive digjitale si, përdorimi i internetit (92.2%), aftësitë digjitale mbi nivelin bazë (30.6%) dhe aftësitë digjitale bazë në krijimin e përmbajtjes (71.8%) tregojnë një performancë të ngjashme: Franca është mbi mesataren e BE-së për sa i përket aftësive digjitale të popullatës por, siç u përmend më lart, renditet pas vendeve lider dhe pikërisht në kuartilin e dytë të vendeve anëtare.

Figura 6: Treguesit kryesorë të performancës në Francë - Aftësitë digjitale bazë ⁸



[8] <https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/policies/europes-digital-decade>



Panorama e përgjithshme digjitale në Shqipëri

Statistikat krahasuese të Eurostat referuar të gjitha shteteve që ndodhen gjeografikisht në kontinentin evropian zbuluan se, në vitin 2023, vetëm 23.32% e shqiptarëve të moshës 16-74 vjeç kishin njohuri digjitale bazë. Kjo ishte përqindja më e ulët mes vendeve të kontinentit.⁹

Figura 7: Treguesit kryesorë të performancës në Shqipëri - Aftësitë digjitale bazë

TIME	Itzerland	United Kingdom	Bosnia and Herzegovina	Montenegro	North Macedonia	Albania	Serbia	Türkiye
2021	77.79	:	34.65	47.21	34.62	23.88	41.38	38.12
2023	77.52	:	38.48	52.82	:	23.32	33.61	33.11

Sipas rezultateve të Anketës mbi Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit (IT) për vitin 2023, 83.1% e popullsisë të moshës 16-74 vjeç përdorin internetin. Të dhënat zyrtare nga Instituti i Statistikave (INSTAT)¹⁰ në Shqipëri mbi "Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Familje, 2023" tregojnë se 32.3% e grupit të moshës 65-74 vjeç në Shqipëri raportojnë se nuk e kanë përdorur kurrë internetin. Kalimi i plotë i shërbimeve publike online, duke hequr shërbimet në sporte fizike, u ka lënë qytetarëve shqiptarë pak alternativa për të aksesuar shërbimet publike. Ndërkohë, sipas të dhënave nga AKEP, vlerësohet se në vitin 2022 norma e penetrimit të aksesit broadband nga rrjete fikse ishte rreth 81% për familje dhe 20.9% për popullatën.

Shqipëria vazhdon të përballet me pengesa në zhvillimin e infrastrukturës së broadband-it, veçanërisht në zonat rurale. Pavarësisht rritjes së vazhdueshme në vitet e fundit, shifrat tregojnë se hendeku mes zonave urbane dhe rurale mbetet i njëjtë. Qasja në internet po bëhet gjithnjë e më shumë një nevojë për marrjen dhe aksesimin e shërbimeve publike, sidomos tani që shumica e shërbimeve të qeverisë ofrohen përmes platformës e-Albania. Kjo paraqet një problem serioz për ata që jetojnë në zona rurale ose për ata me aftësi të ulëta në përdorimin e internetit, duke krijuar një hendek të rëndësishëm për qytetarët që jetojnë në zona rurale për të aksesuar shërbimet e ofruara online. Për të adresuar këtë çështje, është e nevojshme të zhvillohet një skemë mbështetëse.

[9] https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/TEPSR_SP410__custom_1227093/bookmark/table?lang=en&bookmarkId=14c634ce-9867-4c12-9361-06e4343152fa

[10] <https://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/teknologjis%C3%AB-s%C3%AB-informacionit-dhe-komunikimit-tik-n%C3%AB-familje-dhe-nga-individ%C3%ABt/publikimet/2023/p%C3%ABrdorimi-i-teknologjis%C3%AB-s%C3%AB-informacionit-dhe-komunikimit-n%C3%AB-familje-2023/>



GJETJET KRYESORE

Barrierat për përfshirjen e të moshuarve në botën digjitale



Përfshirja digjitale është një formë përfshirje shoqërore, kryesisht për shkak të kompetencës së ulët ose të pasuksesshme digjitale. Pjesëmarrja në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK), qasja në mediat e reja dhe në internet, aftësia për të përdorur shërbime elektronike të nevojshme, motivimi për të përdorur TIK, analiza kritike-konstruktive dhe qëndrimet ndaj TIK janë thelbësore për funksionimin efikas në shoqërinë e informacionit.

Bazuar në inputet nga të moshuarit dhe palët e interesuara në katër shtetet partnere (Shqipëri, Itali, Francë dhe Spanjë), u identifikuan disa barrierat për përfshirjen e të moshuarve në epokën digjitale. Një përmbledhje e sfidave më të rëndësishme me të cilat përballen të moshuarit në lidhje me kompetencën digjitale dhe edukimin në TIK është paraqitur në Figurën 8, ndërsa një analizë e detajuar e barrierave individuale paraqitet në nënkapitujt e mëposhtëm.

Figura 8: Barrierat për përfshirjen e të moshuarve në botën digjitale



• Barrierat infrastrukturore

Mungesa e infrastrukturës pengon ndjeshëm aftësinë e të moshuarve për të fituar aftësi bazë digjitale, duke krijuar një hendek digjital që ndikon në aksesin e tyre në informacion, shërbime dhe marrëdhënie shoqërore. Në Shqipëri, për shembull, shumë zona rurale dhe të largëta ende nuk kanë lidhje të besueshme interneti. Të moshuarit që jetojnë në këto zona shpesh kanë pak ose aspak akses në burime online, gjë që e pengon zhvillimin e aftësive digjitale. Edhe në zonat urbane, përballueshmëria e internetit mund të jetë një pengesë për ata me të ardhura të ulëta. Mungesa e pajisjeve digjitale është gjithashtu e dukshme në këto zona. Të moshuarit mund të mos kenë akses në pajisje digjitale si kompjuterët, tabletët ose telefonat inteligjentë, të cilat janë thelbësore për ushtrimin dhe zhvillimin e aftësive digjitale.



• Barrierat arsimore dhe edukative

Pengesat edukative paraqesin sfida të mëdha për të moshuarit në përshtatjen me teknologjitë digjitale. Mungesa e programeve arsimore të orientuara dhe e sistemeve mbështetëse e bën të vështirë për të moshuarit të mësojnë dhe të angazhohen me mjetet digjitale. Për më tepër, qasja e kufizuar në kompjuterë dhe pajisje të tjera digjitale është një pengesë e madhe, pasi shumë të moshuar mbështeten në telefonat mobil që nuk ofrojnë të njëjtën lehtësi si kompjuterët për të aksesuar kurse online dhe burime digjitale. Mungesa e udhëzuesve dhe programeve trajnuese të përshtatura e ndërlikon më tej situatë, duke i lënë të moshuarit të varur nga të tjerët për ndihmë dhe udhëzim. Trajnimi i personalizuar dhe mbështetja e vazhdueshme janë thelbësore për ndërtimin e besimit digjital te të moshuarit.

“Shumë njerëz të moshuar nuk kanë një kompjuter dhe, aktualisht, platformat për ndjekjen e kurseve nga telefonat celularë nuk e lehtësojnë këtë proces. Një nga arsytet më të zakonshme për braktisjen e kurseve që kam vërejtur është pamundësia për të përfunduar kurset duke përdorur një telefon mobil,” - Mësuese nga Spanja.

• Barrierat kulturore

Për disa të moshuar, barrierat gjuhësore ose qëndrimet kulturore ndaj teknologjisë mund të ndikojnë në gatishmërinë e tyre për t'u angazhuar me mjetet digjitale. Pa mjedise mbështetëse që inkurajojnë mësimin dhe të praktikuarit, të moshuarit mund të ndihen të demoralizuar ose të lënë pas dore ndaj të aftësuarit digjital. Shumë të moshuar përjetojnë frikë dhe ankth kur përdorin teknologji të reja, shpesh për shkak të shqetësimeve se mos bëjnë gabime apo se mund të dëmtojnë pajisjet. Kjo frikë mund t'i pengojë ata të provojnë ose angazhohen plotësisht me mjetet digjitale.

“Ndihem i shqetësuar kur nuk mund ta kuptoj si të përdor një pajisje dhe të varem nga dikush ‘më i zgjuar’ më irriton. Për të dhënë një shembull, një gjë që nuk mund ta mbaj mend janë fjalëkalimet. Fakti që gjithmonë duhet të krijosh fjalëkalime të reja dhe llogari të pafundme për pajisje të ndryshme, nuk më ndihmon aspak, nuk jam i shpejtë me teknologjinë.” – Një i moshuar nga Italia



• Barrierat gjuhësore dhe të komunikimit

Barrierat gjuhësore gjithashtu e bëjnë më të vështirë për të moshuarit përdorimin e teknologjisë digjitale, veçanërisht në zonat ku gjuha kryesore e teknologjisë ndryshon nga gjuha e tyre. Shumë të moshuar përballen me mesazhe ose udhëzime të ngatërruara në anglisht, gjë që e bën të vështirë përdorimin e pajisjeve digjitale. Ky hendek gjuhësor mund t'i bëjë ata të ndihen të izoluar dhe më të prirur të mbështeten në mënyrat tradicionale të komunikimit dhe marrjes së informacionit, siç është bërja e thirrjeve telefonike ose ndërveprimi ballë për ballë.

“Shqetësohem nga mesazhe e pakuptueshme, që më të shumtën e herës janë në anglisht.” – I moshuar nga Shqipëria.

• Barrierat fizike

Barrierat fizike gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në kufizimin e përfshirjes digjitale të të moshuarve. Ndërsa njerëzit plaken, ata mund të përjetojnë probleme me shikimin, dëgjimin dhe aftësinë për t'u përshtatur, gjë që mund ta bëjë të vështirë ndërveprimin me pajisjet digjitale. Të moshuarit shpesh përballen me sfida si, leximi i teksteve të vogla në ekrane, dallimi i alarmeve të ndryshme audio, ose përdorimi i ekraneve me prekje dhe tastierave nëse kanë dridhje ose koordinimi i kufizuar i lëvizjes së duarve.

Barrierat fizike - probleme shikimin dhe dëgjimin, dridhja e duarve. – Një i moshuar nga Franca.

• Aksesi i ulët në shërbimet publike dhe informacion

Digjitalizimi i shërbimeve publike paraqet një pengesë tjetër të rëndësishme për përfshirjen e të moshuarve në epokën digjitale. Ndërsa shumë procese administrative dhe qeveritare kalojnë në internet, të moshuarit mund të hasin vështirësi në aksesimin e shërbimeve thelbësore si: paraqitja e taksave, menaxhimi i llogarive të shëndetit, aksesimi i transportit publik, qendrave komunitare, etj. Sigurimi që këto platforma të jenë miqësore për përdoruesit dhe të aksesueshme për ata me aftësi të kufizuara digjitale është thelbësor.



“Digjitalizimi i shërbimeve në Shqipëri ka paraqitur sfida për shumë qytetarë, veçanërisht për të moshuarit dhe të rinjtë që nuk kanë njohuri ose aftësi për të përdorur internetin. Si rezultat, ata shpesh duhet të shpenzojnë para për shërbime zyrash ose noterie për të marrë dokumente nga platforma digjitale e-Albania. Për të siguruar një akses efektiv në shërbimet digjitale, është thelbësore të ofrohet udhëzim për popullatën mbi mënyrën e përdorimit të këtyre platformave online.”
Instruktur IT nga Shqipëria.”

• Mbështetje e kufizuar nga qeveria

Përmirësimi i aftësisë digjitale të të moshuarit kërkon një qasje shumëdimensionale, që përfshin përmirësimin e infrastrukturës, rritjen e mbështetjes nga qeveria dhe zhvillimin e programeve të trajnimit të përshtatura. Italia, Franca dhe Spanja kanë infrastrukturë më të mirë për të mbështetur programet e aftësisë digjitale, krahasuar me Shqipërinë, ku zonat rurale janë veçanërisht të pambuluara. Franca dhe Spanja kanë strategji më të plota kombëtare për përfshirjen digjitale, ku përfshihen masa të veçanta për të moshuarit, ndërsa Italia ka bërë përpjekje për të adresuar pasigurinë rajonale. Në Shqipëri mungon një strategji kombëtare që do të mundësonte koordinimin dhe mbështetjen e përpjekjeve lokale, siç janë partneritetet me organizatat joqeveritare për të ofruar trajnime për aftësitë digjitale.

Kërkesat kryesore për trajnimin e stafit që merren me ofrimin e kurseve të TIK për të moshuarit



Ndërsa bota digjitale po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme në jetën e përditshme, sigurimi që të moshuarit të mund të angazhohen në mënyrë efektive me Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) është thelbësor. Kjo kërkon një qasje të specializuar për trajnimin e stafit që merret me ofrimin e kurseve të trajnimit TIK për të moshuarit. Instruktorët/ mësimehmënit duhet të pajisen me aftësitë, njohuritë dhe qëndrimet e duhura për të adresuar sfidat unike me të cilat përballen të moshuarit në mësimin e teknologjive digjitale. Palët e interesuara të përfshira në analizë u pyetën rreth aftësive që duhet të fitojnë instruktorët/ mësimehmënit në trajnimet e dedikuara për ta. U sugjeruan disa aftësi të domosdoshme duke përfshirë aftësitë sociale, metodat inovative të mësimdhënies dhe të kuptuarit e nevojave të të moshuarve për t'u aftësuar në fushën digjitale. Një përmbledhje e këtyre aftësive paraqitet në Figurën 9, ndërsa një analizë e detajuar e temave të trajnimit të instruktorëve/ mësimehmënsve paraqitet më poshtë.

Figura 9: Kërkesat kryesore për trajnimin e instruktorëve/mësuesve



• Trajnimi i vazhdueshëm dhe përmirësimi i aftësive

Zhvillimi i vazhdueshëm profesional është i rëndësishëm për instruktorët për të qëndruar të përditësuar me përparimet më të fundit në TIK dhe metodologjitë e mësimdhënies. Sesionet e rregullta të trajnimit, punëtoritë dhe seminarët mund t'i ndihmojnë mësuesit të përmirësojnë aftësitë e tyre dhe të përshtaten me trendet e reja në edukimin digjital. Mësimi i vazhdueshëm siguron që instruktorët të jenë të mirëpajisur me aftësitë e nevojshme për të adresuar nevojat e ndryshme të të moshuarve në edukimin për TIK.

• Pedagogjia e specializuar dhe metodat adaptuese

Instruktorët duhet të trajnohen në pedagogji të specializuar që merr parasysh nevojat unike të mësimin të të moshuarve. Kjo përfshin zhvillimin e metodologjive që i përgjigjen ritmeve dhe stileve të ndryshme të mësimin, siç janë seancat praktike, ndihmësit vizualë dhe aktivitete interaktive. Instruktorët gjithashtu duhet të kenë aftësi në përdorimin e teknologjive dhe mjeteve adaptuese që përmirësojnë aksesueshmërinë dhe përdorshmërinë për të moshuarit me kufizime fizike ose njohëse.



- **Hartimi i udhëzuesve dhe tutorialeve**

Zhvillimi i udhëzuesve dhe tutorialeve të dedikuara është e rëndësishme për lehtësimin e mësimin të TIK për të moshuarit. Instruktorët duhet të trajnohen për të hartuar materiale mësimore që janë të qarta, të shkurtra dhe të përshtatshme me nevojat e të moshuarve. Udhëzuesit duhet të përfshijnë udhëzime hap pas hapi, ndihmës vizualë dhe shembuj nga jeta reale për të përmirësuar kuptimin dhe mbajtjen mend.

- **Lojërat dhe teknikat inovative të mësimdhënies**

Përfshirja e lojërave dhe teknikave inovative në procesin e mësimdhënies mund ta bëjë mësimin e TIK më tërheqës dhe argëtues për të moshuarit. Të mësuarit përmes lojërave përfshin përdorimin e elementeve të ngjashme me lojërat, si pikët, shpërblimet dhe sfidat, me qëllim motivimin dhe ruajtjen e interesit të nxënësve. Kjo qasje mund të ndihmojë në transformimin e njohurive në mënyrë më të thjeshtë dhe të shpejtë shoqëruar me një përvojë të këndshme për të moshuarit, duke i inkurajuar ata të marrin pjesë aktivisht dhe të mos heqin dorë nga edukimi i tyre.

- **Aftësitë sociale dhe komunikimi**

Aftësitë e forta sociale janë thelbësore dhe të domosdoshme për trajnerët që ofrojnë edukim për të moshuarit. Zotërimi i këtyre aftësive do t'i ndihmojë ata t'ia dalin në përpyjekjet për të angazhuar të moshuarit në mënyrë efektive gjatë seancave të trajnimit. Komunikimi i qartë dhe i aksesueshëm është i rëndësishëm, po ashtu edhe aftësia për të shpjeguar konceptet e komplikuar në terma të thjeshtë dhe të kuptueshëm. Mësuesit duhet të përqendrohen në krijimin e një lidhjeve personale me të moshuarit, duke krijuar një atmosferë miqësore dhe të hapur, ku 'nxënësit' e moshuar ndihen komod për të bërë pyetje dhe për të shprehur shqetësimet e tyre.

- **Durimi dhe empatia**

Durimi dhe empatia janë cilësi thelbësore për instruktorët e IT që ofrojnë kurse mësimdhënëse për të moshuarit. Kuptimi që të moshuarit mund të marrin më shumë kohë për të kuptuar konceptet e reja dhe mund të kenë nevojë për shpjegime të përsëritura është thelbësor. Instruktorët duhet të tregojnë gatishmëri për të dëgjuar shqetësimet e të moshuarve, të pranojnë frikërat e tyre dhe të ofrojnë siguri dhe inkurajim. Kjo qasje empatike ndihmon në krijimin e një mjedisi mbështetës mësimor ku të moshuarit ndihen të vlerësuar dhe të kuptuar.

Teknologjitë efektive për aftësimin digjital të të moshuarve



Hendeku digjital mes të moshuarve është një çështje e rëndësishme, pasi përparimet teknologjike vazhdojnë të shënjojnë përditshmërinë. Zvogëlimi i këtij hendeku kërkon identifikimin dhe zbatimin e mjeteve dhe teknologjive efektive të përshtatura me nevojat unike të mësimin të të moshuarve. Në kërkimin tonë, shqyrtoam perspektivat e të moshuarve dhe palëve të interesuara, përfshirë bibliotekat publike, organizatat për të moshuarit që ofrojnë programe dhe shërbime edukative në TIK për të moshuarit, si dhe institucionet akademike.

Qëllimi ynë ishte të përcaktonim mjetet dhe metodat më efektive për mësimin e aftësive digjitale për të rriturit mbi 45 vjeç me nivele të ndryshme të aftësive digjitale. Një përmbledhje është e paraqitur në Figurën 10, ndërsa një analizë e detajuar e teknologjive ose mjeteve që janë veçanërisht efektive për mësimin e aftësive digjitale për të moshuarit paraqitet në kapitujt pasues.

Figura 10: Teknologjitë ose mjetet që janë veçanërisht efektive për mësimin e aftësive digjitale për të moshuarit



• Pajisje të lehta për t'u përdorur

Shumë të moshuar kanë akses të kufizuar në pajisje digjitale dhe shpesh kanë vetëm telefona inteligjentë. Trajnimi efektiv duhet të përqendrohet në pajisjet që përdoren gjerësisht, si telefonat inteligjentë, duke përfshirë organizimin e workshop-eve të fokusuara në një gamë sa më të gjerë të mënyrave të përdorimit të tyre për kërkime në internet, sigurinë në rrjet, e-mail, menaxhimin e rrjeteve sociale dhe procedurat online. Tabletat dhe iPads, me ndërfaqet e tyre miqësore për përdoruesin, janë më të lehta për t'u naviguar nga të moshuarit, se sa kompjuterët tradicionalë. Aplikacionet në këto pajisje mund të personalizohen për t'iu përshtatur niveleve dhe interesave të ndryshme të mësimin.

Pajisjet me ndërfaqe të thjeshtuara dhe ekrane më të mëdha, si Chromebook-et ose kompjuterat e projektuar posaçërisht për të moshuarit (p.sh., Telikin), mund të jenë shumë efektive.



Zhvillimi i tabletëve si GrandPad, të dizajnuara për personat mbi 75 vjeç, e bën më të lehtë përdorimin e tyre, nëpërmjet ofrimit të një ndërfaqeje të lehtë për përdorim që mundëson lidhjen e lehtë me internetin pa kompleksitetin e telefonave celularë ose tabletëve tradicionalë.

- **Platformat e mësimi online dhe aplikacionet e specializuara**

Platformat e mësimi online të aftësive bazë digjitale janë bërë mjete thelbësore në uljen e hendekut digjital tek të moshuarit. Platformat si, Coursera, Udemy dhe Khan Academy ofrojnë kurse të dizajnuara posaçërisht për të moshuarit ose fillestarët në aftësitë digjitale. Këto kurse pajisin të moshuarit me aftësitë bazë kompjuterike, që i ndihmojnë ata për të qëndruar në kontakt me fëmijët, nipërit, miqtë dhe familjen. Aplikacione si Eldy, të cilat ofrojnë një përvojë të thjeshtuar të email-it dhe internetit, si dhe udhëzuesit për aplikacione si Facebook ose Zoom, ndihmojnë të moshuarit të lidhen me të dashurit e tyre online.

- **Tutoriale interaktive**

Websitet si GCFGlobal dhe TechBoomers ofrojnë mësim falas dhe të lehta për t'u ndjekur nga personat me aftësi të ulëta digjitale, duke rritur njohuritë dhe aftësitë e tyre në këtë fushë, përfshirë përdorimin e mediave sociale, email-it dhe shfletimin bazik të internetit. YouTube ka shumë kanale të dedikuara për të mësuar të moshuarit si të përdorin teknologjinë nëpërmjet udhëzimeve 'hap pas hapi'. Të preferuara janë videot e shkurtra, mësimet dhe infografikët e thjeshtë, pasi ato ofrojnë informacion të përmbledhur dhe të lehtë për t'u kuptuar. Telefonatat "VideoCall" dhe seancat interaktive mund të ndihmojnë në mësimin në kohë reale dhe japin mundësinë e reagimit të personit që ndodhet në rolin e nxënësit, përfshi të moshuarit.

- **Mediat sociale dhe komunikimi online për të moshuarit**

Teknologjia i mundëson të moshuarve të qëndrojnë të lidhur me median sociale, të cilat janë bërë shumë popullore ndër të moshuarit. Nuk bëhet fjalë vetëm për ndarjen e fotove apo lajmeve, por gjithashtu për krijimin e lidhjeve dhe zvogëlimin e vetmisë. Lojërat interaktive dhe simulimet që mësojnë aftësi digjitale mund ta bëjnë procesin e të mësuarit më të këndshëm për të moshuarit. Faqet si Lumosity ofrojnë lojëra kognitive që gjithashtu përmirësojnë aftësitë e orientimit digjital.

- **Teknologjia për të Moshuarit – Një Qendër Burimesh**

Tech for Senior", një komunitet në Facebook, shërben si një burim i rëndësishëm. Ata ofrojnë transmetime të drejtpërdrejta dhe episode të arkivuara të emisionit të tyre në faqen e tyre, duke siguruar një platformë interaktive për pyetje, këshilla dhe shoqëri. Kanali i tyre në YouTube ofron udhëzime vizuale për të thjeshtuar kuptimin e teknologjisë, duke përfshirë gjithçka, nga vendosja e video-thirrjeve deri te eksplorimi i hobeve të reja në internet. Me burime të tilla, që janë lehtësisht të disponueshme, njohja e rrjeteve sociale bëhet më pak e frikshme dhe më ftuese.

Roli i institucioneve në promovimin e kompetencave digjitale mes të moshuarve

Roli i qeverive në promovimin e aftësive digjitale tek të moshuarit është thelbësor për arritjen e gjithëpërfshirjes digjitale.

Përmes zbatimit të strategjive të targetuara, krijimit të partneriteteve dhe rritjes së ndërgjegjësimit, qeveritë mund të përmirësojnë ndjeshëm shkrim-leximin digjital, duke fuqizuar qytetarët që të marrin pjesë plotësisht në botën digjitale. Këto përpjekje kontribuojnë në përfshirjen sociale, pavarësinë dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për popullatën e moshuar.

Itali

Italia ka nisur disa programe për të rritur shkrim-leximin digjital tek të moshuarit, shpesh në bashkëpunim me komunitetet lokale dhe organizatat private. Këto iniciativa përfshijnë kurse dhe workshop-e falas për shkrim-leximin digjital, të përqendruara në aftësitë praktike të nevojshme për jetën e përditshme, si marrja e shërbimeve bankare online dhe aksesimi i shërbimeve qeveritare. Dy masa kryesore të orientuara drejt sigurimit të aftësive digjitale bazë për qytetarët përfshijnë:

- Shërbimi Qytetar Digjital:¹¹ Në vitin 2023, ky program përfshiu rreth 1,900 vullnetarë të rinj, të cilët ndihmuan rreth 80,000 qytetarë.¹²
- Rrjeti i Shërbimeve të Lehtësimit Digjital: Hapja e 504 pikave të lehtësimit digjital (Punti Digitale Facile) në të gjithë vendin gjatë vitit 2023 mbështeti rreth 6,000 persona në përdorimin e shërbimeve digjitale.

Francë

Qeveria franceze ka zbatuar projekte të ndryshme nën strategjinë e saj kombëtare digjitale, duke u fokusuar në kapërcimin e hendekut digjital përmes arsimit dhe mbështetjes së aksesueshme. Iniciativat kryesore përfshijnë:

- Hub Francilien:¹³ Ofron trajnime dhe burime për të moshuarit.
- Trajnimi i Këshilltarëve Digjitalë: Synon të trajnojë 20,000 "ndihmues" deri në vitin 2025, për të mbështetur mbi 2 milionë francezë në kryerjen e shërbimeve digjitale.

Këto masa janë kyçe për zvogëlimin e hendekut digjital, veçanërisht në zonat rurale, dhe për trajtimin e çështjeve që lidhen me centralizimin e aktiviteteve dhe vendimmarrjeve ekonomike.

[11] <https://www.italiadomani.gov.it/content/sogei-ng/it/en/Interventi/investimenti/competenze-digitali-di-base.html>

[12] <https://digitale.regione.emilia-romagna.it/punti-digitali-facile>

[13] <https://www.francilin.fr/>



Spanjë

Spain's approach includes comprehensive digital inclusion programs targeting rural and less-populated areas. Volunteer-led training and awareness campaigns promote digital skills as essential for enhancing the quality of life and independence among seniors.

Key initiatives include:

- Generation D Campaign: Launched in 2023 by RTVE to explain digital transformation and help citizens adapt.¹⁴
- Pact for Generation D: A government initiative gathering over 200 members and 900 learning initiatives.
- Digital Rural Challenge Plan: Announced in February 2023 with a EUR 90 million investment to train over 380,000 people in rural areas by 2025.¹⁵
- Digital Skills for Children Program (CODI): Launched to teach digital skills to children, with a EUR 97 million grant allocated to train over 418,000 children.

Spain also participated in the European Digital Skills Certificate pilot and implemented various programs for advanced digital skills, such as the State Network of Digital Training Centres.

Shqipëri

In Albania, significant efforts have been made in digitizing public services, but challenges remain in ensuring equitable access for citizens with limited digital skills or access to IT equipment. The European Commission's Albania 2023 Report¹⁶ highlights the need to improve labor market relevance and quality of vocational education and training (VET) and invest in the digital skills of young people and adults.

Efforts must focus on reducing the digital divide across communities, strengthening digital transformation in education and training systems, and enhancing digital security and personal data protection, especially after recent cyberattacks.

[14] <https://mijasinternational.com/actualidad/27939/generation-d-an-initiative-to-bridge-the-digital-divide/>

[15] https://ec.europa.eu/enrd/sites/enrd/files/enrd_publications/digital-strategies_case-study_es.pdf

[16] https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/QANDA_23_5612



Spanjë

Qasja e Spanjës përfshin programe gjithëpërfshirëse për përfshirjen digjitale, duke u fokusuar në zonat rurale dhe ato me popullsi të vogël. Trajnime dhe fushata ndërgjegjësimi të drejtuara nga vullnetarët, promovojnë aftësitë digjitale të nevojshme për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe pavarësisë ndër të moshuarit.

Iniciativat kryesore përfshijnë:

- Fushata “Generation D”: E nisur në vitin 2023 nga RTVE për të shpjeguar transformimin digjital dhe për t’i ndihmuar qytetarët të përshtaten.¹⁴
- Pakti për “Generation D”: Një iniciativë qeveritare që mbledh mbi 200 anëtarë dhe 900 iniciativa mësimore.
- Plani i Sfidës Digjitale Rurale: I shpallur në shkurt 2023 me një investim prej 90 milionë euro për të trajnuar mbi 380,000 persona në zonat rurale deri në vitin 2025.¹⁵
- Programi i Aftësimin Digjital për Fëmijë (CODI): I nisur për të mësuar aftësitë digjitale tek fëmijët, me një grant prej 97 milionë eurosh të alokuara për të trajnuar mbi 418,000 fëmijë.

Spanja gjithashtu u përfshi në pilotimin e Certifikatës Evropiane të Aftësive Digjitale dhe implementoi programe të ndryshme për aftësi digjitale të avancuara, si Rrjeti Shtetëror i Qendrave të Trajnimit Digjital.

Shqipëri

Në Shqipëri janë bërë përpjekje të konsiderueshme për digjitalizimin e shërbimeve publike,¹⁶ por ende ka sfida në sigurimin e aksesit të barabartë për qytetarët me aftësi të ulëta digjitale ose akses të kufizuar në pajisje IT. Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2023 thekson nevojën për të përmirësuar lidhjen me internet, për të rritur cilësinë e arsimit dhe formimit profesional (VET) dhe për të investuar në aftësitë digjitale të rinjve dhe të rriturve.

Përpjekjet duhet të fokusohen në zvogëlimin e hendekut digjital ndërmjet komuniteteve, forcimin e transformimit digjital në sistemet e arsimit dhe formimit profesional, përmirësimin e sigurisë digjitale dhe mbrojtjes së të dhënave personale, veçanërisht pas sulmeve të fundit kibernetike.

[14] <https://mijasinternational.com/actualidad/27939/generation-d-an-initiative-to-bridge-the-digital-divide/>

[15] https://ec.europa.eu/enrd/sites/enrd/files/enrd_publications/digital-strategies_case-study_es.pdf

[16] https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/QANDA_23_5612

REKOMANDIME



01.

Të priorizohet investimi në edukimin dhe aftësitë digjitale - Institucionet publike duhet të alokojnë burime për të zhvilluar dhe zbatuar programe gjithëpërfshirëse të aftësimin digjital për të moshuarit dhe për të siguruar që financimi të mbështesë si infrastrukturën teknologjike, ashtu edhe iniciativat edukative.



02.

Të mbështetet mësimi dhe ekspozimi ndaj STEM - Duke promovuar mësimin gjatë gjithë jetës në ICT dhe inkurajuar ekspozimin herët në STEM, institucionet mund të krijojnë një mjedis mbështetës si për të moshuarit ashtu edhe për të rinjtë. Këto përpjekje janë thelbësore për të zhvilluar kompetencat digjitale dhe për të siguruar që të gjithë brezat të jenë të përgatitur për të naviguar në sfidat dhe mundësitë e një bote gjithnjë e më digjitale. Për më tepër, inkurajimi i ekspozimit të hershëm në STEM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë) për të rinjtë, veçanërisht vajzat, është thelbësor për krijimin e mundësive për mësim të të gjithë brezave.



03.

Të shfrytëzohen qendrat komunitare dhe bibliotekat - Qendrat komunitare dhe bibliotekat janë burime të vlefshme për promovimin e aftësimin digjital ndër të moshuarit, duke ofruar hapësira të aksesueshme dhe mbështetje të personalizuar të përshtatur për nevojat e tyre. Në vendet e BE-së si Franca, Italia dhe Spanja, këto institucione janë të konsoliduara dhe të mirë-pajisura për të ofruar një gamë të gjerë programesh aftësimi digjital. Ndryshe nga ato, Shqipëria përballlet me sfida unike të cilat po përpiqet t'i adresojë nëpërmjet partneriteteve strategjike dhe iniciativave lokale. Duke shfrytëzuar këto burime komunitare, vendet mund të sigurojnë që të moshuarit të jenë të pajisur me aftësitë digjitale të nevojshme për të përparuar në botën e sotme të drejtuar nga teknologjia.



04.

Të inkurajohet partneriteti publik-privat - Institucionet publike duhet të kërkojnë aktivisht bashkëpunime me kompani të sektorit privat dhe organizata jofitimprurëse për të krijuar mundësi inovative për mësimin digjital. Këto partneritete mund të shfrytëzojnë ekspertizën dhe burimet e ndryshme për të zgjeruar programet e aftësimin digjital dhe për të arritur një audiencë më të gjerë.



05.

Të investohet në infrastrukturën digjitale - Qeveritë duhet të përqendrohen në përmirësimin e ofrimit të internetit në zonat rurale dhe ato të paaksesueshme. Nëpërmjet investimit në infrastrukturë, mund të sigurohet akses për të gjithë qytetarët në shërbime digjitale të përballueshme dhe të besueshme, duke kapërcyer kështu hendekun digjital.



06.

Të zhvillohet ndërgjegjësimi për sigurinë digjitale - Institucionet duhet të ofrojnë programe trajnimi për sigurinë digjitale, duke u përqendruar në mbrojtjen e të dhënave personale dhe praktikave të zakonshme të sigurisë në internet. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet grupeve të cenueshme, përfshirë të moshuarit, për t'i pajisur ata me njohuritë e nevojshme për të lundruar në mjedise digjitale në mënyrë të sigurt.



07.

Të promovohet edukimi i vazhdueshëm dhe përmirësimi i aftësive - Inkurajimi i individëve për t'u angazhuar në të mësuarit gjatë gjithë jetës, nëpërmjet ofrimit të aksesit në platforma online që ofrojnë mundësi alternative të mësuari. Këto platforma duhet të përshtaten me etapa të ndryshme të karrierës dhe rrethana të jetës, duke i ndihmuar individët të përshtaten me ndryshimet në peizazhin teknologjik.



08.

Të sigurohet akses në shërbime publike digjitale - Është e rëndësishme që shërbimet publike digjitale të jenë të sigurta, të ndërveprueshme dhe të aksesueshme për të gjithë, përfshirë të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara. Investimet dhe masat rregullatore duhet të përqendrohen në projektimin e ndërfaqeve miqësore dhe sistemeve mbështetëse për të siguruar përfshirjen e të gjithëve.



09.

Të mbështetet aftësimi digjital përmes angazhimit komunitar - Shfrytëzimi i qendrave komunitare, bibliotekave dhe organizatave lokale për të ofruar trajnime dhe punëtori që synojnë aftësimin digjital dhe mbështetje të personalizuar. Këto mjedise mund të shërbejnë si qendra të mësimit digjital, nëpërmjet ofrimit të burime dhe ndihmës për individët që kërkojnë të përmirësojnë aftësitë e tyre digjitale.



PRAKTIKAT MË TË MIRA

Çdo partner ka identifikuar 3-5 praktika të mira në fushën e aftësive digjitale dhe përfshirjen e të moshuarve në të mësuarit digjital në shkallë kombëtare (Shqipëri, Francë, Itali, Spanjë). Qëllimi është të shqyrtohen qasjet e suksesshme, nismat e aftësimit në fushën digjitale, si dhe projektet të cilat kanë dëshmuar ndikim në kapërcimin e mungesës së aftësive dixhitale, të cilat kanë potencialin të ri-aplikohen në vende të tjera dhe kontekste të ndryshme.

AUTORITETI/ ORGANIZATA PËRGJEGJËSE

Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA)

Rritja e aksesit të romëve në shërbimet publike online në e-Albania

Kjo iniciativë kishte si qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe aftësive të komunitetit rom për të aksesuar shërbimet përmes platformës digjitale e-Albania. Projekti iu përgjigj sfidave me të cilat u përballën anëtarët e komunitetit rom në pamundësinë për të aksesuar shërbimet publike bazë, pas kalimit të menjëhershëm dhe të paparalajmëruar në shërbime 100% online, me një vendim të Qeverisë shqiptare. Një zyrë mobile u përdor për të lehtësuar aksesin në shërbimet publike për romët në zonat e largëta të bashkive Divjakë dhe Lushnjë.

AKTIVITETET KRYESORE

Sesione informimi për anëtarët e komunitetit Rom për aksesimin e shërbimeve online në portalin e-Albania

Sesione informimi në grupe me 10-15 pjesëmarrës u organizuan pranë vendbanimeve rome. Lehtësuesit lokalë të IRCA-s trajnuan anëtarët e komunitetit rom në aftësi bazë për përdorimin e platformës e-Albania, që nga hapat për hapjen e llogarisë personale në portalin online deri tek përdorimi i tij për të marrë shërbimin e nevojshëm dhe çdo dokument personal që gjenerohet nëpërmjet platformës.

Ndihmë direkte për romët për të aksesuar shërbimet online

U ofrua ndihmë e drejtëpërdrejtë për individët përmes një zyre mobile të improvizuar (minivan) për ata që nuk kishin akses në internet ose pajisje elektronike, përfshirë të moshuarit dhe individët me aftësi të kufizuara.

Ofrimi i Kartës së Identitetit

100 anëtarë të komunitetit rom u ndihmuan në aplikimet për kartën e identitetit, e cila është thelbësore për aksesimin e portalit, nëpërmjet ofrimit të kuponave falas, pasi shpenzimet u mbuluan nga projekti.



Efektiviteti

Projekti u realizua me sukses në dy bashki të Shqipërisë, ku u organizuan 10 sesione informimi me rreth 150 pjesëmarrës nga komuniteti rom, të cilët përmirësuan në mënyrë të konsiderueshme aftësitë për të përdorur portalin e-Albania. Përgjatë projektit, u ndihmuan drejtpërdrejtë 100 individë të aksesonin shërbimet online dhe të pajiseshin me kartën e identitetit.



Vlerësimi i Transferueshmërisë

Aftësitë dhe njohuritë digjitale të fituara nga pjesëmarrësit do t'u mundësojnë atyre të vazhdojnë të aksesojnë shërbimet online edhe pas përfundimit të projektit. Pjesëmarrësit gjithashtu mund të transferojnë njohuritë e tyre tek anëtarët e tjerë të komunitetit.

PERIUDHA

Gusht 2023 – Shkurt 2024

VENDNDODHJA

Bashkitë e Lushnjës dhe Divjakës në Shqipëri

INFORMACION SHITESË

Komuniteti rom vuan nga niveli i ulët arsimor, ku shumë anëtar të komunitetit janë analfabetë. Projekti theksoi nevojën e vazhdueshme për të përmirësuar aftësitë digjitale të anëtarëve të komunitetit. Të rinjtë, të cilët përshtaten shpejt me ndryshimet teknologjike, u identifikuan si grupi kyç për ndërhyrjet afatshkurtra, pasi ata mund të ndihmojnë anëtarët e tjerë të familjes. Përshtatja e qasjeve sipas nevojave individuale, përmes takimeve ballë për ballë dhe punës në grupe të vogla, u tregua efektive për transferimin e njohurive tek grupet vulnerabël.



AKTIVIZON.AL

Platformë mësimore online për personat që punojnë me të rinjtë dhe profesionistët

Platforma Aktivizon.al është një platformë virtuale për personat që punojnë me të rinjtë dhe profesionistët në Shqipëri, e cila ofron një qasje mësimore të pavarur dhe fleksibël.

AKTIVITETET KRYESORE

Trajnim dhe mentorim online

Platforma ofron akses në të mësuarit përmes përdorimit të trajnimeve online, pa pasur nevojë për takime ballë për ballë me një trajner/lehtësues.

Në platformë gjenden 5 module të krijuara nga ekspertë në 5 fusha të punës me të rinjtë, sipas modelit të Kornizës Europiane të Kualifikimeve dhe teorisë gjithëpërfshirëse të të nxënës gjatë gjithë jetës nëpërmjet arsimit dhe formimit profesional.

Platforma gjithashtu ka integruar një numër mjetesh digjitale, si padlet, mentimeter, kahoot etj., të cilat do ta bëjnë mësimin më interaktiv për përdoruesit.

Çdo trajnim ka si qëllim rritjen e kapaciteteve të pjesëmarrësve, duke përmirësuar njohuritë, qëndrimet, aftësitë dhe sjelljen e tyre. Një trajner/lehtësues mbështet trajnime gjatë periudhave të fillimit të kurseve.

AUTORITETI/ ORGANIZATA PËRGJEGJËSE

Beyond Barriers Association



Efektiviteti

Platforma përmban 5 module trajnimi online:

1. Edukimi për të drejtat e njeriut në punën me të rinjtë.
2. Edukimi joformal dhe qasja ndaj kompetencave në punën me të rinjtë
3. Të drejtat sociale
4. Vullnetarizmi, vlerat dhe përfitimet tek të rinjtë
5. Edukimi ndërkulturor në punën me të rinjtë



Vlerësimi i Transferueshmërisë

Në shtator 2024, stafi i organizatës Përtej Barrierave filloi përgatitjet për të përfshirë një tjetër modul në platformë përmes mbështetjes nga fondet e kaskadës së programit Horizon të BE. Moduli përfshin metoda online për të trajnuar kërkuesit e rinj në metodologjinë ORR, përmes mjeteve e-learning (mesimi online), për t'i pajisur ata me aftësitë e nevojshme dhe për ta aplikuar metodologjinë në sektorin e rinisë dhe sektorë të tjerë.

PERIUDHA

Filluar në nëntor 2022 (kurset e para) dhe vijon

VENDNDODHJA

Platformë online, Shqipëri

INFORMACION SHITESË

Kurset në platformë zhvillohen bazuar në një kalendar të caktuar nga BBA, janë në gjuhën shqipe dhe ofrohen falas për çdo person të interesuar gjithandej nëpër Shqipëri - mjafton të ketë akses në internet. Platforma synon që çdo të ri shqiptar që ka njohuri bazike në përdorimin e internetit të mund ta përdorë lehtësisht.





AUTORITETI/ ORGANIZATA PËRGJEGJËSE

ASDO – Albania Sustainable Development Organization
<https://asdo.al/en/projects/bibliotech>

BIBLIOTECH

Programi BiblioTech ka si qëllim transformimin e hapësirave publike në qendra teknologjike, që t'u shërbejnë si të rinjve edhe të moshuarve në komunitet. Programi fokusohet në rritjen e njohurive digjitale për sigurinë e fëmijëve dhe adoleshentëve, duke kontribuar në një komunitet më të fortë dhe më të aftë teknologjisë.

AKTIVITETET KRYESORE

Që nga hapja e tij në vitin 2019, BiblioTech ka pasur disa arritje të rëndësishme:

- Ka realizuar më shumë se 120 sesione informim dhe trajnimi në më shumë se 30 shkolla dhe Kënde BiblioTech, duke angazhuar 815 fëmijë dhe të rinj.
- Ka organizuar tre edicione të 'Sfida BiblioTech', një program mentorimi dhe konkurrimi në të cilin janë përfshirë 440 të rinj nga Tirana, Shkodra, Kukësi dhe Korça.
- Janë mbajtur katër Tech Camp, në të cilat është ofruar trajnim për më shumë se 90 të rinj nga Shkodra dhe Tirana.
- Janë prodhuar dhe publikuar 18 video-tutoriale online si mjete mësimore.
- Janë arritur më shumë se 750 mijë të rinj përmes mediave sociale me mesazhe mbi aftësitë digjitale, sigurinë online dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Programi planifikon të vazhdojë fuqizimin e të rinjve shqiptarë duke:

- u zgjeruar në rajone dhe bashki të tjera;
- zhvilluar programe dhe module trajnimi të reja dhe inovative;
- përmirësuar përvojën e të rinjve në Këndet ekzistuese BiblioTech.



Efektiviteti

Projekti BiblioTech fokusohet në:

- Angazhimin e komuniteteve dhe rrjeteve ekzistuese.
- Përdorimin e burimeve lokale njerëzore dhe infrastrukturore.
- Minimizimin e ndikimit në mjedis dhe kostove të udhëtimit.
- Përmirësimin e kapaciteteve të stafit dhe ekspertëve lokalë.



Vlerësimi i Transferueshmërisë

Programi angazhon të gjithë anëtarët e komunitetit, nga fëmijët deri tek të moshuarit, duke ofruar aftësi thelbësore për zhvillimin e komunitetit, informacion mbi sigurinë kibernetike dhe edukimin digjital. Programi synon rritjen e aftësive personale të punëmarrësve të ardhshëm në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

PERIUDHA

Filloi në vitin 2019 dhe është në vazhdim

VENDNDODHJA

Shqipëri

INFORMACION SHITESË

Kjo ndërhyrje ka treguar qëndrueshmëri, efikasitet dhe ndikim të gjerë në komunitet, nëpërmjet pajisjes së qytetarëve me aftësi digjitale të nevojshme dhe nëpërmjet nxitjes së tyre për t'u angazhuar pozitivisht dhe për të përparuar në komunitetet e tyre.

Për më shumë informacion, ju lutem vizitoni www.asdo.al



Nonni su Internet

Nonni su Internet / Gjyshërit në internet

Objektivat e projektit përfshijnë trajnimin e vullnetarëve të specializuar për të ndihmuar moshat e treta të rrisin aftësitë e tyre digjitale. Vullnetarët duhet të kenë aftësi të mira në teknologjinë e informacionit, menaxhim, mësimdhënie dhe marrëdhënie personale. Anëtarët e komunitetit të çdo moshe dhe gjinie mund të bëhen mësimdhënës vullnetarë si: studentët dhe mësuesit pensionistë.

AKTIVITETET KRYESORE

Klasat zhvillohen në ambiente të pajisura me kompjuterë. Nxënës janë banorë lokalë mbi 60 vjeç, madje edhe vetë gjyshërit e nxënësve të shkollave ose persona të tjerë të moshuar që marrin shërbime në qendra sociale.

Në çdo shkollë të përfshirë në projekt krijohen klasa me 20-25 të moshuar. Nxënësit e shkollave luajnë rolin e mësuesve për të moshuarit. Nxënësit veprojnë nën udhëheqjen dhe koordimin e mësuesit të IT që është ekspert i teknologjisë së informacionit. Raporti ideal nxënës/ të moshuar është 1/2.

Kohëzgjatja e kursit falas është 30 orë gjithsej, që shtrihet në 15 javë, nga dy orë në javë. Të moshuarit pjesëmarrës, nxënësit e angazhuar si patronazhistë, si dhe mësuesit mbikqyrësues në fund të kursit pajisen me certifikatë pjesëmarrjeje. Projekti u certifikua nga shkollat si pjesë e pakëtes ekstrakurrikulare, duke u përfshirë në Planin e Ofertës së Trajnimit (Piano dell'offerta formativa) dhe akorduar kredite për nxënësit patronazhistë/kujdestarë.

AUTORITETI/ ORGANIZATA PËRGJEGJËSE

Fondazione Mondo Digitale



Efektiviteti

Në 14 edicionet e projektit për aftësimin digjital për personat mbi 60 vjeç, të realizuara deri tani, janë pajisur me certifikatë 30,000 të moshuar, 21,000 nxënës kujdestarë dhe 2,100 mësues koordinatorë (ekspertë IT-je).

Në vitin shkollor 2015-2016, ky model mësimi mes brezave u aplikua në 20 rajone të Italisë dhe në 11 shtete të ndryshme.

PERIUDHA

2007 - në vazhdim (18 edicione)

VENDNDODHJA

Klasa shkollore në Itali

INFORMACION SHITESË

Për më shumë informacion, ju lutem vizitoni <https://www.mondodigitale.org/en/projects/nonni-su-internet>



DIGIBREAKER PLUS

AUTORITETI/ ORGANIZATA PËRGJEGJËSE

Fondazione Mondo Digitale

Digi-Breaker+

Thyerja e barrierave dhe ndërtimi i komunitetit për një digjitalizim efektiv, të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të udhëzuesit të shërbimeve për të rriturit.

AKTIVITETET KRYESORE

- **Studim:** Mbledhja dhe analizimi i 30 rasteve që ilustrojnë përdorimin e mjeteve dhe metodologjive digjitale në fushën e punësimit.
- **Kapërcimi i hendekut:** Zhvillimi i mjeteve multimediale për të integruar zgjidhje digjitale në shërbimet e orientimit për të rriturit, duke promovuar zhvillimin e aftësive dhe rritur mundësitë për punësim.
- **Plani i Veprimit për Zhvillimin e Komunitetit:** Ndërtimi i një rrjeti ndërkombëtar shërbimesh të orientuara drejt edukimit të të rriturve.
- **Zbatimi i Qasjes DIGI-BREAKER (ndërmjetësi digjital):** Inkurajimi i operatorëve, konsulentëve, qendrave lokale të trajnimit si dhe bibliotekave që adoptojnë metoda digjitale inovative.
- **Kurse të Integruara me Aktivitete praktike (Lab-activities):** Aplikimi praktik i informacionit të fituar për kërkimin e punës. Plani Strategjik i Veprimit: Zhvillimi i një udhëzuesi rekomandimesh për politika në transferimin dhe zgjerimin e rezultateve në vendet e interesuara.
- **Kurs i Hapur Online Masiv (MOOC):** Ofrimi i një kursi 3-orësh që fokusohet në kompetencat e gjelbra dhe digjitale për të integruar qëndrueshmërinë në kërkimin e punës. Kursi përfshin tre module, secili me nga tre mësimet 20-minutëshe: Aftësitë Bazë, Grupi dhe Klasifikimi i Aftësive Tuaja, Rregullimi dhe Struktura e Aftësive Tuaja



Efektiviteti

Digi-Breaker+ harton, zhvillon dhe teston një kuadër aftësish digjitale të bazuar në qëndrueshmëri. Ky kuadër do të jetë i disponueshëm si një e-libër dhe kurs online i hapur për të rriturit dhe konsulentët e punësimit, duke promovuar një qasje digjitale, të gjelbër, të hapur dhe shumë- dimensionale për udhëzimin në karrierë. Objektivi i tij është të nxisë dialogun midis të rriturve të papunë dhe konsulentëve të karrierës/ mësuesve për të rriturit, duke rritur ndërgjegjësimin mbi integrimin e qëndrueshmërisë digjitale në kërkimet për punë.

PERIUDHA

Dhjetor 2022 – Nëntor 2024

VENDNDODHJA

Belgjikë, Itali, Lituani, Suedi, Bullgari

INFORMACION SHITESË

Falë një portofoli materialesh didaktike dhe një qasjeje të hapur, projekti adreson nevojën për të kualifikuar dhe rikualifikuar punonjësit për t'u përshtatur me transformimet e tregut gjatë tranzicionit drejt një ekonomie të qëndrueshme.

Partnerët e projektit:

- [Alphabet Formation](#), Belgjikë (partner kryesor)
- Fondazione Mondo Digitale, Itali
- [All Digital Aisbl](#), Belgjikë
- [Imotec](#), Lituani
- [Igitogo](#), Suedi
- [Globalni Biblioteki](#) – Bullgari



Smile

SMart Innovative Learning for Employment

Projekti fokusohet në zhvillimin e aftësive bazë digjitale (si Microsoft 365 dhe inteligjenca artificiale/generative AI/ChatGPT) dhe aftësive profesionale në fusha si: shitje, shërbim ndaj klientit, tregti, dizajn grafik dhe marketing në media sociale.

AKTIVITETET KRYESORE

Projekti SMILE ka si qëllim të ndihmojë individët e papunë dhe të paangazuar të grupmoshës 34-50 vjeç që të ri-integrohen në tregun e punës, nëpërmjet rritjes dhe përmirësimit të aftësive digjitale. Këto aftësi i shtojnë vlerë përvojës profesionale ekzistuese dhe lehtësojnë riintegrimin e tyre në tregun e punës.

Kurset e trajnimit janë fleksibël dhe ofrohen nëpërmjet moduleve specifike, të ndara në tri fusha kryesore, me 40 orë secila prej tyre:

- **Aftësitë për Jetën:** Përfshijnë menaxhimin e stresit, empatinë dhe mendimin kritik.
- **Aftësitë Bazë Digjitale:** Përfshijnë njohuritë dhe aftësitë në përdorimin e programeve të Microsoft 365 (Word, Excel, PowerPoint) dhe inteligjencën artificiale generative.
- **Aftësitë Digjitale Specifike për Profesionin:** Të përshtatura për fusha të veçanta të punës.

AUTORITETI/ ORGANIZATA PËRGJEGJËSE

Fondazione Mondo Digitale



Efektiviteti

Projekti SMILE implementon një metodologji të re trajnimi që integron kompetencën e "të mësuarit të të nxënimit".

Kjo qasje inkurajon pjesëmarrësit të vlerësojnë nevojat e tyre për trajnim, të kërkojnë, të zgjedhin dhe të shfrytëzojnë Burimet Edukative të Hapura (OER), që janë në dispozicion online. Procesi mbështetet në ndërveprimin e vazhdueshëm të patronazhistëve dhe trajnerëve brenda komunitetit 'Smart Learning', i frymëzuar nga metodologjia Smart Learning Design, e zhvilluar nga Politecnico di Milano.

Projekti përfshin një 'Katalog-Bibliotekë' kursesh, të cilat i lejojnë përfutuesit të zgjedhin, me udhëzimin e një konsulenti – trajneri, për të përmirësuar potencialin dhe profilin e tyre profesional për sistemimin në punë. Një chatbot i disponueshëm në platformë ofron ndihmë të vazhdueshme gjatë sesioneve të punës individuale. Projekti planifikon të realizojë 16 edicione klase, me rreth 15 pjesëmarrës në secilën prej tyre. Pjesëmarrësit mund të kenë akses në të gjitha kurset në katalog-bibliotekë në periudha të ndryshme gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit.

PERIUDHA

2022-2026


VENDNDODHJA

Itali



AUTORITETI/ ORGANIZATA PËRGJEGJËSE

Centro per l'educazione ai media (Itali)



Efektiviteti

Workshop-et u përqendruan në përdorimin efektiv dhe krijues të mediave të reja dhe aplikacioneve në aftësimin digjital, duke zhvilluar metodologji inovative për integrimin e edukimit mediatik dhe digjital tek emigrantët në moshë, si dhe promovimin e përfshirjes sociale dhe përmirësimin e kompetencave sociale, qytetare dhe ndërkulturore. Të 45 workshop-et e pilotuara janë të disponueshme për shkarkim në anglisht nga faqja e projektit, me përshkrime të detajuara dhe materiale vizuale që lehtësojnë riprodhimin dhe përshtatjen e tyre nga ana e trajnerëve dhe mësuesve.

Migrant Liter@cies

Migrant Liter@cies është një projekt i bashkëfinancuar nga programi Erasmus+ i Komisionit Evropian, me qëllim zhvillimin e praktikave të reja në përdorimin e mjeteve të teknologjisë së informacionit, për edukimin mediatik dhe digjital të emigrantëve në moshë (refugjatë, azilkërkues, të rinj dhe gra emigrante).

AKTIVITETET KRYESORE

Projekti synon të zhvillojë forma të ndryshme të të nxënit, të përshtatura me kontekstet kombëtare të vendeve partnere, duke ofruar mjete inovative për edukatorët dhe mësuesit. Kjo përfshin zhvillimin e 45 workshop dhe 8 paketave didaktike, të fokusuar në mësimin e gjuhës duke përdorur aftësitë e TIK-ut dhe edukimit mediatik.

- **Zhvillimi i workshop dhe paketave didaktike:** Krijimi i 45 workshop dhe 8 paketave didaktike, me qëllim mësimin e gjuhëve të huaja duke përdorur aftësitë e TIK-ut dhe edukimit mediatik.
- **Studim:** Identifikimi i praktikave dhe metodologjive të mira në programet e alfabetizimit për emigrantët e rritur, që përdorin metoda inovative të TIK-ut për mësimin e gjuhës dhe përdorimin e mediave sociale.
- **Trajnime:** Pjesëmarrja në trajnime e stafit të partnerëve dhe rreth 200 edukatorëve në 8 shtete të Evropës.
- **Zbatimi:** Realizimi i 45 workshop pilot me rreth 500 emigrantë, duke testuar dhe zbatuar praktika inovative në TIK për integrimin e alfabetizimit dhe mediave.

TIMELINE

2017

LOCATIONS

Belgjikë, Estoni, Itali, Gjermani, Holandë, Poloni, Sllovaki, Spanjë

INFORMACION SHITESË

Për më shumë informacion, vizitoni
<https://www.migrantliteracies.eu/>



Construir un mundo para todas las edades

Trabajamos para visibilizar el envejecimiento, concienciar sobre el mismo y reducirlo poniendo en valor las aportaciones de las personas mayores a la sociedad.

MÁS INFORMACIÓN



Klasa të Hapura Mini-workshope

Duke pasur parasysh shoqërinë që po bëhet gjithnjë e më digjitalizuar dhe hendekun digjital që mund të kufizojë aksesin e të moshuarve në informacion, Fondacioni "la Caixa" ofron mjete dhe burime për t'i integruar ata në botën digjitale. Projekti ofron seanca trajnimi të shkurtra, ose mini-punëtori, të orientuara për vullnetarët e moshuar. Këta vullnetarë më pas ndihmojnë të tjerët në qendrat e tyre komunitare për t'u njohur me aplikacionet digjitale të zakonshme.

AKTIVITETET KRYESORE

Fondacioni "la Caixa" ofron këto mini-punëtori, secila prej të cilave zgjat 4 seanca nga 2 orë secila:

- **Hyrje në 'Kompjuterat dhe Komunikimin në Internet':** Bazat e përdorimit të kompjuterëve dhe komunikimit online.
- **Procedurat në Internet:** Mësimi i përdorimit të mjeteve digjitale për të ndërvepruar me shërbimet qeveritare përmes "Dosja ime qytetare".
- **Dosja Ime Qytetare:** Menaxhimi i të dhënave dhe kryerja e procedurave me administratën publike, si rinovimi i kartave të identitetit ose trajtimi i çështjeve të tatimeve.
- **Shëndeti Im:** Navigimi në sistemet e shëndetit publik online, qasja në dosjet shëndetësore, kërkesa për takime dhe shkarkimi i testeve diagnostikuese.
- **Rezervime Online:** Aftësitë për blerjen e biletave për ngjarje të caktuara ose blerje online, duke identifikuar dhe shmangur mashtrimet.
- **Financa Online:** Përdorimi i sigurt i bankave online dhe aplikacioneve financiare, duke përfshirë aplikacione si Bizum.

AUTORITETI/ ORGANIZATA PËRGJEGJËSE

Fundación "la Caixa"



Efektiviteti

Programi ka qenë i suksesshëm, me 406,351 të moshuar që kanë marrë pjesë në 16,986 aktivitete në 629 qendra gjatë vitit akademik 2022-2023. Punëtoritë ndihmojnë të moshuarit të fitojnë aftësi të reja, të përmirësojnë ato ekzistuese dhe të zbulojnë aftësi të reja. Kurrikula promovon marrëdhënie, mirëqenie, zhvillim personal dhe pjesëmarrje aktive shoqërore mes të moshuarve.



Vlerësimi i Transferueshmërisë

Kjo praktikë mund të përshtatet për projektin DIGI-LEARN, pasi të dyja iniciativat synojnë të ofrojnë aftësi digjitale për popullatat e rrezikuara, veçanërisht të moshuarit. Elementët e dukshëm transferues përfshijnë praninë e gjerë të kurseve në të gjithë Spanjën dhe trajnimin e vullnetarëve nga e njëjta gjeneratë si pjesëmarrësit, çka nxit një lidhje dhe kuptim më të thellë mes mësuesve dhe nxënësve.

PERIUDHA

2022-2024

VENDNDODHJA

Spanjë

INFORMACION SHITESË

Fondacioni "la Caixa" ka mbi një shekull përvojë në programet për të moshuarit, duke adresuar sfidat e plakjes, nxitur zhvillimin personal dhe ndërtuar marrëdhënie mbështetëse për një jetë të plotë, të angazhuar në pjesëmarrjen shoqërore.

Për më shumë informacion, vizitoni <https://fundacionlacaixa.org/es/home>

AUTORITETI/ ORGANIZATA PËRGJEGJËSE

National University of Distance Education (UNED)



Efektiviteti

Kursi u ndoq plotësisht, duke i siguruar pjesëmarrësve mjetet e nevojshme për të kapërcyer hendeqet digjitale.



Vlerësimi i Transferueshmërisë

Kjo praktikë mund të aplikohet në mënyrë efektive në projektin DIGI- LEARN, i cili gjithashtu ka për qëllim të kapërcejë hendequn digjital. Veçanërisht, kjo praktikë ofron disa karakteristika të vlefshme: përmbajtja është e aksesueshme online, përmes seancave live dhe të regjistruara. Seancat janë të shkurtra, me vetëm dy orë secila, gjë që ndihmon përdoruesit të ruajnë përqendrimin. Kjo plotësohet me platforma online, që përmbajnë video, materiale shitesë dhe forume ku përdoruesit mund të bëjnë pyetje relevante.

PERIUDHA

Nga 5 tetor deri në 30 nëntor 2020

VENDNDODHJA

Navarra, Spain

INFORMACION SHITESË

Për të marrë certifikatën e kursit, pjesëmarrësit duhet të përgjigjen saktënjë pyetësor të shkurtëpër secilën seksion në platformën MOODLE.

Për më shumë informacion, vizitoni <https://extension.uned.es/actividad/23005>

Aftësimi digjital për të moshuarit: kapërcimi i hendequt digjital

Universiteti Kombëtar i Arsimit në Distançë (UNED) ofron një kurs falas prej 40 orësh, i financuar nga Qeveria e Navarrës. Programi synon të ofrojë për moshat e treta kurse trajnimi, mjete dhe burime digjitale, për të ulur kështu hendequn digjital mes brezave. Nisma mbështet plakjen aktive dhe të shëndetshme, duke kapërcyer hendequn mes teknologjive dhe popullatës që nuk i përket moshës digjitale. Ky kurs promovon aftësitë teknologjike të moshës së tretë, duke zgjeruar aksesin në njohuri dhe aktivitete sociale në kushte të ngjashme me pjesën tjetër të popullsisë.

AKTIVITETET KRYESORE

Programi përbëhet nga 20 kurse, secili prej të cilëve zgjat 2 orë, që pjesëmarrësit mund t'i ndjekin të ndara ose si një set të plotë. Ata që regjistrohen dhe kalojnë të gjithë kursin, fitojnë 2 kredite sipas Kornizës Europiane të Kualifikimeve. Një platformë MOODLE mbështet sesionet me video dhe materiale, dhe pjesëmarrësit mund të ndërveprojnë me lektorët për pyetje. Seancat e trajnimit përfshijnë seanca online që udhëhiqet nga trajneri ose nëpërmjet sesioneve të regjistruara.

Tema kryesore përfshijnë:

- Prezantimi i Internetit: Navigimi në internet dhe e-mail
- Përdorimi i telefonave mobil: iPhone dhe Android
- Mësimi i përdorimit të WhatsApp
- Thirrje video dhe videokonferenca: lidhja me familjen dhe miqtë
- Përdorimi i rrjeteve sociale



AUTORITETI/ ORGANIZATA PËRGJEGJËSE

Instituto Leonés de Desarrollo Económico, Formación y Empleo (ILDEFE)

Mbështetje Online për Aftësimin Profesional të Personave në Nevojë

Projekti synon të përmirësojë kualifikimet profesionale të profesionistëve mbështetës që punojnë me të rritur të papunë, pjesë e grupeve vulnerabël. Ai përqendrohet në zhvillimin e aftësive bazë teknologjike, zbatimin e metodologjive të suksesshme nga rajone të tjera dhe zhvillimin e kompetencave teknologjike të individëve në disavantazh, duke ulur kështu pengesat e tyre për hyrjen në tregun e punës.

AKTVITETET KRYESORE

Projekti ofron mjete ICT për ofrimin e shërbimeve dhe trajnimeve për të rritur të papunë, heq pengesat për burimet online për grupet në kushte të vështira dhe implementon platforma trajnimi të dizajnuara përtelëfona inteligjentë. Përgjatë projektit janë zhvilluar dy trajnime në nivel ndërkombëtar:

- T1: "Adresimi i Pengesave të Mësimin Online të Grupet në Kushte të Vështira"
- T2: "Analiza e Mjeteve ekzistuese ICT për Zhvillimin Shërbimeve Online për të Rritur të Papunë në Kushte të Vështira"

Aktivitetet Kryesore:

- Arrija e përfshirjes sociale dhe në tregun e punës për të papunët në kushte të vështira përmes mësimin të aftësive themelore përmes mjeteve ICT.
- Përmirësimi i profileve profesionale të përfituesve, veçanërisht të të rriturve të cenueshëm, duke ofruar aftësi kyçe për një mjedis digjital.
- Fuqizimi i të rriturve që përballen me pengesa, duke u siguruar tyre aftësi praktike dhe njohuri për kërkimin e punës duke përdorur pajisje digjitale.
- Përmirësimi i shërbimeve online për individët e papunë.
- Rritja e aftësive të ekipeve të shërbimeve të punës për të adresuar sfidat e mësimin në lidhje me barazinë, diversitetin dhe përfshirjen përmes mjeteve ICT.



Efektiviteti

Ky projekt ka qenë shumë efektiv në ofrimin e mjeteve ICT për të rritur të papunë, duke eliminuar kështu pengesat për qasjen në burimet online për grupet në kushte të vështira.



Vlerësimi i Transferueshmërisë

Kjo praktikë mund të përshtatet për projektin DIGI-LEARN, pasi ofron trajnime për profesionistët për të avancuar kualifikimet e tyre në digjitalizim, dhe mbështetur kështu të rritur të papunë në kushte të vështira.

PERIUDHA

Shtator 2020- Gusht 2022

VENDNDODHJA

León, Spanjë

INFORMACION SHITESË

Për më shumë informacione, vizitoni <https://erasmus-plus.ec.europa.eu/projects/search/details/2020-1-ES01-KA204-082753>

The Project

DigIT aims to promote digital skills among adult educators for them to be able to design high-quality digital educational programs for senior learners.

Creating high-quality learning opportunities for seniors and fostering an active aging lifestyle addressing the digital gap of this group has become a key priority for the European Union as exemplified by the recent Green Paper on Digital and the call of Erasmus+ to include all generations particularly seniors. DigIT has highlighted not only the obstacles that this range of population face as lack of digital skills and

DigIT: Promovimi i aftësive digjitale tek të moshuarit

Projekti DigIT ka si qëllim promovimin e aftësive digjitale të trajnerëve/ instruktorëve që punojnë me të moshuarit, në mënyrë që ata të jenë në gjendje të krijojnë programe edukative digjitale me cilësi të lartë.

OBJEKTIVAT

Projekti synon që të nxisë dhe promovojë punën e trajnerëve/instruktorëve që merren me aftësimin digjital të të moshuarve, si mënyrë që këta të fundit të kenë një plakje aktive. Përmes krijimit të një broshure me mjete dhe forma digjitale për t'u përdorur në mësimdhënien tek personat mbi 60 vjeç dhe ofrimin të mundësive të trajnimit, projekti ka kontribuar në zhvillimin profesional të instruktorëve dhe në ofrimin e mundësive të mësimin cilësor për të moshuarit, veçanërisht për ata me nivel të ulët aftësish, njohurish dhe kompetencash.

- Promovimi i shkëmbimit të praktikave të mira dhe metodologjive të mësimdhënies, duke inkurajuar bashkëpunimin ndërkombëtar mes organizatave, fuqizimin e organizatave të përfshira, veçanërisht në drejtim të përdorimit të mjeteve inovative digjitale.
- Ofrimi i mundësive të trajnimit në nivel ndërkombëtar për trajnerët dhe instruktorët që ofrojnë trajnime për moshat e treta. Këto trajnime organizohen mes profesionistëve nga vende të ndryshme, duke forcuar identitetin evropian dhe të nxënies ndërkulturor.
- Fuqizimi i facilitatorëve dhe edukatorëve mbi mënyrën se si të promovojnë kompetencat kryesore digjitale dhe zhvillimin individual të të moshuarit.
- Eksplorimi i mjeteve të ndryshme digjitale që mund të përdoren për hartimin e kurrikulave mësimore për të moshuarit.
- Zhvillimi i aftësive digjitale të të moshuarve.

AUTORITETI/ ORGANIZATA PËRGJEGJËSE

ADI & SALUS SERSOC SL (Spanjë); Associação Animam Viventem (Portugali); BASE3 Società Cooperativa (Itali).



Efektiviteti

Përmes kësaj praktike janë trajnuar me sukses një numër i madh mësuesish, të cilët më pas kanë fuqizuar personat me aftësi të ulëta digjitale, duke ndihmuar në kapërcimin e hendekut digjital mes të moshuarve dhe grupet e tjera vulnerable.



Vlerësimi i Transferueshmërisë

Metodologjia e këtij projekti mund të përshtatet për të adresuar hendekun digjital dhe mund të aplikohet për të mësuar çdo lëndë me interes për qytetarët.

PERIUDHA

1 Mars 2022 - 2 Korrik 2023

VENDNDODHJA

Spanjë, Itali dhe Portugali

INFORMACION SHITESË

Për më shumë informacion, vizitoni <https://www.projectdigit.eu/>



AUTORITETI/ ORGANIZATA PËRGJEGJËSE

ADI & SALUS SERSOC SL (Spanjë); Associação Animam Viventem (Portugali); BASE3 Società Cooperativa (Itali).

Vëmendja teknologjike në bibliotekë

Ofrimi i asistencës teknologjike në biblioteka

AKTIVITETET KRYESORE

Këshilli i A Coruña angazhon një specialist për të ofruar asistencë teknologjike të personalizuar për individët që kanë vështirësi në përdorimin e pajisjeve digjitale në secilën nga shtatë bibliotekat e qytetit. Shërbimi është i disponueshëm pa nevojë për takim, sipas parimit të "atë që vjen i pari, shërbehet i pari", dhe ofrohet në orare të ndryshme gjatë javës, duke përfshirë ndihmë në distancë nëse është e nevojshme.

Eksperti ofron ndihmë me detyra të tilla si rezervimi i takimeve për administratën publike, mësimi i përdorimit të pajisjeve digjitale dhe bërja e telefonatave të mjekët. Eksperti ofron udhëzime, por nuk kryen detyra në emër të përdoruesit.



Efektiviteti

Ky shërbim është shumë efektiv pasi ofron mbështetje teknologjike të personalizuar, duke adresuar nevojat specifike të përdoruesit. Për shembull, eksperti mund të ndihmojë me detyra si dërgimi i një CV-je në një kompani ose lidhja me një takim në Teams.



Vlerësimi i Transferueshmërisë

Kjo praktikë e mirë mund të transferohet në projektin DIGI-LEARN për shkak të fleksibilitetit dhe asistencës teknologjike të personalizuar që u ofrohet individëve në nevojë.

PERIUDHA

E hënë - e premte, me orare të caktuara që ndryshojnë nga biblioteka në bibliotekë. Asistenca në distancë është gjithashtu e disponueshme.

VENDNDODHJA

Biblioteka të ndryshme në bashkinë A Coruña

INFORMACION SHITESË

Përveç asistencës teknologjike të personalizuar, bibliotekat ofrojnë një program edukativ gjithëpërfshirës, që synon të ndihmojë qytetarët të përmirësojnë aftësitë e tyre digjitale. Kurset, të cilat janë pa pagesë, mbulojnë tema të ndryshme si "Celulari nga Zeroja," "Kompjuteri nga Zeroja," dhe "Procedurat Administrative," duke promovuar përdorimin e sigurt, kritik dhe të përgjegjshëm të pajisjeve digjitale për kohën e lirë, punën dhe pjesëmarrjen aktive në shoqëri. Për ata që preferojnë, është gjithashtu e disponueshme ndihma në distancë.

Për më shumë informacion, vizitoni

<https://www.coruna.gal/bibliotecas/gl/usa-as-bibliotecas/as-bibliotecas-ofrecenche/atencion-tecnologica?argldioma=gl>

Solidarité Numérique, c'est la plateforme d'aide au service des citoyens pour tous leurs besoins numériques



La plateforme propose :

Ce site internet solidarite-numerique.fr regroupe des ressources pour les personnes ayant des compétences numériques de base et pouvant apprendre seules.



Solidarité Numérique/ Solidariteti digjital

Ofrimi i asistencës digjitale dhe burimeve për të moshuarit dhe individët në nevojë.

AKTIVITETET KRYESORE

Solidarité Numérique ofron një shërbim linjë telefonike për të ndihmuar qytetarët në përdorimin e mjeteve digjitale. Platforma ofron udhëzues dhe tutoriale online për tema të ndryshme digjitale, si dhe organizohen sesione informuese individuale për të zgjidhur probleme specifike.

Shërbimet kryesore përfshijnë:

- **Asistencë telefonike:** Një linjë telefonike e dedikuar për këshillime të personalizuara mbi përdorimin e mjeteve digjitale.
- **Udhëzues dhe tutoriale online:** Burime online që mbulojnë tema si përdorimi i e-mailit, navigimi në internet dhe aksesimi i shërbimeve publike online.
- **Mbështetje individuale:** Seanca individuale për të adresuar çështje specifike që lidhen me teknologjinë digjitale.

AUTORITETI/ ORGANIZATA PËRGJEGJËSE

Projekti menaxhohet nga Sekretari i Shtetit për Tranzicionin Digjital dhe Komunikimet Elektronike, nën mbikëqyrjen e ANCT.



Efektiviteti

Platforma "Solidarité Numérique" mbikëqyret nga programi "Shoqëria Digjitale" i ANCT, me mbështetje operacionale nga MedNum, kooperativa kombëtare e aktorëve të ndërmjetësimit digjital. Që nga krijimi i saj, mbi 30,000 individë kanë marrë mbështetje të personalizuar.



Vlerësimi i Transferueshmërisë

Ky projekt mund të transferohet me sukses në vendet me ngjashmëri socio-ekonomike me Francën, ku pabarazitë dixhitale janë gjithashtu të pranishme.

PERIUDHA

2020

VENDNDODHJA

Francë

INFORMACION SHITESË

Për më shumë informacion, vizitoni <https://www.solidarite-numerique.fr/a-propos/>



SPORT

JO 2024 : Ce que les Français redoutent le plus



VOYAGE

JO 2024 : Le défi des transports



YOU GOV DATA

Découvrez l'ensemble de nos études et articles

YouGov

AUTORITETI/ ORGANIZATA PËRGJEGJËSE

YouGov

Zgjidhje Digjitale për të Luftuar Izolimën e të Moshuarve

Programi fokusohet në ofrimin e trajnimeve dhe mbështetjes për të moshuarit në përdorimin e mediave sociale, duke synuar të kapërcejë hendekun digjital dhe të luftojë izolimin tek të moshuarit. Programi ofron një qasje gjithëpërfshirëse, që përfshin workshop-e praktike, mentorim individual dhe grupe mbështetëse online.

AKTIVITETET KRYESORE

• Trajnime dhe workshop-e

Organizimi i workshop-eve praktike për të moshuarit për të mësuar përdorimin e Facebook dhe Messenger, duke përfshirë krijimin e llogarive, navigimin në "News Feed", postimin dhe ndërveprimin. Sesionet trajtojnë gjithashtu sigurinë dhe privatësinë online, duke përfshirë rregullimet, mbrojtjen e informacionit personal dhe zbulimin e mashtrimeve online. Pjesëmarrësit mësojnë të përdorin Messenger për dërgimin e mesazheve, fotove, realizimin e thirrjeve me video dhe menaxhimin e njoftimeve.

• Mentorim individual

Mentorim individual për vullnetarët e rinj ose trajnerët digjitalë për të adresuar pyetje specifike dhe çështje teknike, duke ndihmuar të moshuarit të fitojnë besim dhe aftësi në përdorimin e mjeteve digjitale.

• Online Support Groups

Krijimi i grupeve në Facebook për të moshuarit, ku ata mund të ndajnë përvoja, të bëjnë pyetje dhe të marrin këshilla, duke krijuar një komunitet mbështetës dhe duke nxitur inkurajimin mes bashkëmoshatarëve.



Efektiviteti

Anketat e kryera nga YouGov në vitet 2017 dhe 2019 theksojnë efektivitetin e programit, duke treguar se 75% e të moshuarve ishin online në vitin 2017, dhe 70% përdorën internetin për të kërkuar informacion mbi blerjet, edhe kur blinin në dyqane fizike. Këto statistika demonstrojnë një angazhim të konsiderueshëm digjital midis të moshuarve.



Vlerësimi i Transferueshmërisë

Strategjitë digjitale të përdorura për të targetuar të moshuarit mund të jenë efektive dhe të transferueshme edhe në kontekste të tjera.

PERIUDHA

2017 dhe në vazhdim

VENDNDODHJA

Paris, Francë

INFORMACION SHITESË

Për më shumë informacion, vizitoni

<https://fr.yougov.com/>

MEDIATION NUMÉRIQUE

Pour votre transformation numérique

Quel que soit votre projet, nous vous aiderons à rendre pertinent votre TPE/PME dans le monde du numérique.

Toutes les formations

Votre compagnon pour votre digitalisation ou votre reconversion professionnelle.



Mediatorët digjitalë

Edukimi digjital dhe mbështetje për të moshuarit dhe individët në nevojë

AKTIVITETET KRYESORE

Kjo iniciativë përqendrohet në mësimin e aftësive specifike digjitale, zgjidhjen e problemeve teknike dhe edukimin e individëve mbipraktikat e mira digjitale përmes mbështetjes të personalizuar dhe trajnimit të përshtatur, shpesh të ofruara në shtëpi.

Aktivite kryesore:

Mbështetje dhe trajnime të personalizuar: Ofrimi i sesioneve trajnime të përshtatura në shtëpi për të ndihmuar individët të zhvillojnë aftësitë digjitale thelbësore për përdorim të përditshëm.

AUTORITETI/ ORGANIZATA PËRGJEGJËSE

Agence Nationale de la Cohésion des Territoires (ANCT) / Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit



Efektiviteti

Në vitin 2022, rreth 650,000 persona kërkuan asistencë përmes këtij programi.



Vlerësimi i Transferueshmërisë

Ndërsa shumë vende evropiane synojnë të përshpejtojnë tranzicionet digjitale, mediatorë digjitalë mund të luajnë një rol të rëndësishëm në ndihmën ndaj individëve dhe komuniteteve për t'u përshtatur dhe për të përfituar nga teknologjitë e reja. Për të qenë efektivë, këta mediatorë duhet të jenë të disponueshëm në gjuhë të ndryshme dhe të marrin parasysh specifikat kulturore dhe sociale të çdo rajoni evropian.

PERIUDHA

2020 dhe në vijim

VENDNDODHJA

Paris, Francë

INFORMACION SHITESË

Për më shumë informacion, vizitoni <https://www.mediation-numerique.fr/>



Pass Numérique

Faciliter l'accès à des formations d'initiation ou de perfectionnement aux outils et usages numériques

Le Pass numérique : Qu'est-ce que c'est...



Présentation

Comment cela fonctionne ?
Une personne, dont les difficultés avec le numérique ont été détectées, peut recevoir auprès d'une structure locale (guichet de service public, travailleurs sociaux, espace France Services) un lot de Pass Numériques. Elle est ensuite dirigée vers une structure qualifiée, organisatrice d'ateliers d'initiation ou de perfectionnement au numérique. La structure scannera le Pass et dispensera la formation au bénéficiaire gratuitement. Elle sera ensuite payée par l'opérateur de Pass Numériques.

Pass Numérique

Promovimi i përfshirjes digjitale përmes trajnimeve dhe workshopëve.

AKTIVITETET KRYESORE

Nisma "Pass Numérique" synon të zvogëlojë hendekun dixhital duke ofruar çeqe ose kupona për individët që hasin vështirësi me mjetet digjitale. Këto kupona mundësojnë qasjen në trajnime dhe workshop-e, duke promovuar përfshirjen digjitale dhe mbështetur ata që janë më të largët nga teknologjia. Programi lehtëson tranzicionin digjital duke ndihmuar qytetarët të përdorin shërbimet online të nevojshme për detyrat administrative, punësimin dhe jetën e përditshme.

Aktivitetet kryesore

- Workshop: Organizimi i workshop-ëve për të mësuar aftësi bazë digjitale, si përdorimi i emailit dhe shfletimi në internet. Këto seanca, shpesh të realizuara në bashkëpunim me biblioteka dhe qendra komunitare, ndihmojnë në kapërcimin e hendekut digjital duke pajisur pjesëmarrësit me aftësi digjitale thelbësore.

INFORMACION SHITESË

Për më shumë informacion, vizitoni <https://societenumerique.gouv.fr/fr/dispositif/pass-numerique/>

AUTORITETI/ ORGANIZATA PËRGJEGJËSE

Agence Nationale de la Cohésion des Territoires (ANCT)
/ Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit



Efektiviteti

Që nga viti 2020, janë shpërndarë më shumë se 66,000 certifikata digjitale, duke ofruar mbështetje të rëndësishme për individët në nevojë.



Vlerësimi i Transferueshmërisë

Shumë vende evropiane përballen me sfida të ngjashme lidhur me hendekun digjital, veçanërisht mes të moshuarve, të papunëve, emigrantëve dhe individëve me të ardhura të ulëta. Bashkëpunimi midis vendeve evropiane mund të lehtësojë shkëmbimin e praktikave më të mira, burimeve dhe ekspertizës në përfshirjen digjitale. Projekte pilot ndërkombëtare mund të nisin për të testuar efektivitetin e programit Pass Numérique në kontekste të ndryshme. Është thelbësore që përmbajtja dhe metodat e trajnimit të përshtaten për të plotësuar nevojat specifike të çdo vendi dhe komuniteti gjuhësor.

PERIUDHA

2020 dhe në vijim

VENDNDODHJA

Paris, Francë

REFERENCAT



- <https://ec.europa.eu/eurostat/web/interactive-publications/demography-2024>
- <https://ec.europa.eu/eurostat/web/interactive-publications/demography-2024>
- https://read.oecd-ilibrary.org/employment/preventing-ageing-unequally_9789264279087-en#page57 <https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/policies/europes-digital-decade>
- <https://www.italiadomani.gov.it/content/sogei-ng/it/en/Interventi/investimenti/competenze-digitali-di-base.html>
- <https://digitale.regione.emilia-romagna.it/punti-digitale-facile> <https://www.francilin.fr/>
- <https://mijasinternational.com/actualidad/27939/generation-d-an-initiative-to-bridge-the-digital-divide/> https://ec.europa.eu/enrd/sites/enrd/files/enrd_publications/digital-strategies_case-study_es.pdf
- https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/QANDA_23_5612
- https://akep.al/wp-content/uploads/2023/07/R2022_Treguesit-Statistikore-te-Tregut-te-Komunikimeve-Elektronike-DTMRr_.pdf
- <https://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/teknologjis%C3%AB-s%C3%AB-informacionit-dhe-komunikimit-tik-n%C3%AB-familje-dhe-nga-individ%C3%ABt/publikimet/2023/p%C3%ABrdorimi-i-teknologjis%C3%AB-s%C3%AB-informacionit-dhe-komunikimit-n%C3%AB-familje-2023/>
- https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/TEPSR_SP410__custom_1227093/bookmark/table?lang=en&bookmarkId=14c634ce-9867-4c12-9361-06e4343152fa
- https://avancedigital.mineco.gob.es/programas-avance-digital/Documents/EspanaDigital_2025_TransicionDigital.pdf

DIGI-LEARN

Learning to learn in digital environments




What is DIGI-LEARN?

Digi-Learn is an Erasmus+ project, created to equip people with digital skills in digital environments.

The DIGI-LEARN project aims to equip Europe's citizens to navigate the technology-driven changes in the workplace by **developing best practices for digital skills training** and those with limited digital skills, through **face-to-face training**. The project will produce **strategies to help adult learners** and **develop digital skills** through the program.



 <https://digilearnproject.eu/>

 <https://www.facebook.com/profile.php?id=61558592161946>